

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7483 E premte 30 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
As lidhjet ekonomike dhe politike tradicionale të ngushta me Rusinë nuk patën efekt. Shumica e vendeve europiano-lindore u renditën në aferën ...
Vijon në faqen 20

Nga ROBERT SCHWARTZ
"Bllokada ruse" dhe roli i Shqipërisë


Opinion i Ditës
Vendimi i Edi Ramës për të goditur me një nga taksat më të larta të rajonit udhëtarët e Rrugës së Kombit është një akt i pastër imoral. Jo vetëm ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI
Refuzojeni atë taksë, jo si kosovarë, por si qytetarë



Intervista në "News 24"/ Flet Murat Ahmet Yörük

Ambasadori turk: Aeroporti i Vlorës do të "shpërthejë" turizmin në Shqipëri

"Organizata terroriste FETO shiu në dorë sektorin e arsimit këtu, janë të rrezikshëm"

Nga ERION KAÇORRI

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yörük e konsideroi si nder emërimin e tij në këtë detyrë të re në Shqipëri. Në një intervistë për emisionin "Diplomaticus" në "News 24", diplomati turk ...

Në faqet 6-7

KESHILLI BASHKIAK I TIRANES MIRATON ÇELJEN E PROCEDURAVE PER SHTEPI

VELIAJ: HAPET KREDIA E BUTE, KRITERET PER TA PERFITUAR

Kryebashkiaku: Do të përfitojnë 500 familje të kryeqytetit. I japim zgjidhje strehimit për çiftet e reja. Këstet do të jenë më të ulëta



(Në foto) Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, duke folur gjatë një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak të Tiranës

Në faqen 11

DISKUTIMET PER TAKSEN

Debatet në parlament, Rama: S'ju ndalojmë dot të thyeni qafën. Basha: Llapaqen batutash

Në faqet 2-3

VIZITA E TSPIRAS

Kotzias, takim 3 orë në Tiranë me Bushatin, çelen negociatat teknike për "Detin"

Në faqen 4

PSE VENDOSEM BLOKIMIN

Artan Lame: Pronarët e tokave bujqësore do të përjashtohen nga verifikimi i tapive

Në faqen 5

LISTA E IV

Dosjet e pronarëve në vitin 1997, emrat e vlera e kompensimit për 1462 përfitues

Në faqet 18-19

Zbulohet letra me siglën "sekret" e vitit 1973, shkruar nga sekretari i partisë, Ali Manaj

"Shkrimtarët Matuka e Shehu s'ngritën doli për partinë"

Enveri: S'besoj se doli të filluan me 'shëndetin' e popullit të Kurveleshit"

Nga DASHNOR KALOÇI

Shefqet Peçi ish-komandanti "legjendar" partizan me origjinë nga fshati Pclar i Tepelenës, ku dhe ka lindur më 1 maj të vitit 1906, pas vitit 1945 e deri në shembjen e regjimit komunist të Enver Hoxhës,



mbajti dhe ushtroi një sërë detyrash të larta shtetërore. Nga grada e aspirantit të cilën e kishte fituar që në fillimin e viteve '30-të gjatë periudhës së Monarkisë së Zogut ku ndoqi një kurs specializimi për armën e Artilerisë, falë ...

Në faqet 12-13

AELITA MANI: PUNOJME PER KRIJIMIN E ELITAVE



'Luarasi', prezantim i suksesshëm në panairin "Work & Study"

Në faqen 9

KUVENDI TAKSAT

TRITAN SHEHU

Deputeti Tritan Shehu vuri theksin në parlament tek mungesa e sigurisë së ilaçeve dhe kujdesit paliativ, si shembull i korrupsionit në shëndetësi. Shehu përmendi rastin e rëndë të një djalë 18 vjeçar nga Ballshi me tumor recebral, me metastazë pulmonare, një rast shumë i vështirë.



REFORMA

OERD BYLYKBASHI

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi reagoi mbi punën e Agjencisë së Pronave. "Dikur komunistët pronën e pronarëve e grabitën me grykën e armëve dhe dhunën e shtetit. Sot bëjtë e tyre po përdorin paratë e drogës, korrupsionit, ligjin për investime strategjike dhe Kodin Civil që t'ua marrin përfundimisht dhe përjetësisht pronën ish-pronarëve".



TAKSA

DHURATA ÇUPI

"Skema e rritjes deri në dyfishim të taksave bëri që 30% e familjeve shqiptare të varfërohen. Kjo e dhënë e trishtë krijohet për shkak se niveli i pagave është më i ulët në rajon, ndërsa taksat janë në anën tjetër të kurbës duke u taksuar më shumë. Pas taksës së pronës, nuk ka mbetur më tjetër opsion për t'i lodhur e dërrmuar më tej shqiptarët".

Berisha, deputetit të PS-së: Shko zgjidhe vetë qelinë, se atje do të shkosh

Valentina Madani

Opozita e akuzoi deputetin socialist, Alket Hyseni, për përvetësim të pronës në kundërshtim me ligjin, por ky i fundit i quajti akuzat sulme politike. Hyseni reagoi dhe në lidhje me akuzat që janë bërë për vjedhjen e pronave. Nga foltorja e Kuvendit, ai deklaroi se këto janë akuzat dhe shpifje të inskenuara nga opozita. Ky është një llum, që e bën opozita në bashkëpunim me kazanin. "Doni të fshihni krizën e financimeve nga rusët, por kjo është e pashmangshme. Miqitë e tu (Berishës) kanë 30 hektarë në Ksamil. Unë nuk trembem sepse jam me të drejtë. Një për një do dalin aferat e zullumet e ish-zyrtarëve. Ja ku kam dokumentet ku Flamur Noka, vëllai dhe fisi i vet ka Kukësi kanë marrë një pallat të tërë të të pastrehtëve në Sarandë dhe i bëj thirrje prokurorisë t'i hetojë, e vazhdoi sulmin nga selia Saliانji, që nuk kam çfarë merrem etj.", tha Hyseni. Por pas tij reagoi deputeti i PD-së, Ervin Saliانji, sipas të cilit Hyseni ka kërcënuar familjarët e familjes Bua në Dhërmi. Më pas, Saliانji deklaroi se Hyseni do të shkojë në burg, pasi akuzat janë shumë të rënda. "Ti në vend që të jesh në gjyq dhe para drejtësisë, del këtu në këtë foltoire të nderuar si deputet i Edi Ramës. Me mbrojtjen e tij del dhe përgojon për të thënë që ka edhe të tjerë hajdutë, po mor po... Por, çështja jote është qartësisht abuzive, ti ke marrë 11 mijë metra tokë në mënyrë abuzive në Dhërmi. Dje, një biznesmen, Fatmir Musai në mos gaboj, ju akuzonte se në fshatin e vet turistik ju kishit grabitur 500 metra dhe pavarësisht kallëzimit, prokuroria nuk ju thërrret. Kushedi sa ka të tjerë që do dalin për ju, por ju prapë dilni broçkullisni si njeriu që ju ka rënë në dore barra për të vendosur drejtësi. Ti dhe e gjithë qeveria nuk keni çfarë thonin një gjë të vetme për mua. Ndërsa ti i pari duhet të shkosh në burg zotëri, reforma në drejtësi është që persona si ti, edhe hajdutë me apo pa çizme të përfundoni në burg!", tha z.Saliانji. Por, edhe ish-

Hyseni: Edhe Noka ka vjedhur në Sarandë. Saliانji: Do shkosh në burg

"Je hajdut, more 11 mijë metra tokë në Dhërmi"

kryeministri Sali Berisha shig-jetoi deputetin socialist duke ia treguar qelinë. "Krahasoni ju gjykatësin me një apartament të falur nga e motra - dakord, të hetohet - me katër apartamente nga madamë Rama, e cila ka drejtuar në bashkëpunim të vetëm një fondacion joftimprurës!! U fol për 100

mijë euro dhuratë! Kaq ka ajo një dhuratë të deklaruar bashkë me motrën! Lexoni pak: Bashkë me motrën! Pra, me këto standarde... Le të marrim pak kryebashkiakët. Kryebashkiaku i Rrogzhihës, 10 ha a më shumë, ndiqet në gjendje të lirë. Nuk kam asnjë kundërshtim. Për ndjekje,

absolutisht! Alket, edhe ti duhet të ndiqesh, por kur të vijë koha. Po, po! Do të të vijë koha ty. Sot ty të mbron Rama, po nesër do të të vijë koha. Mirë, vazhdo, por do të të vijë koha! Elvis Roshi ndërton me Olsi Ramën në tokën e vjedhur. Frroku mbahet në arrest shtëpie, të mos komu-

nikojë me njeri. Me zbatim të njëanshem, Ti (i drejtohet Hysenit) e di ç'ke ti?! Shko zgjidhe vetë më mirë qelinë. Zgjidhe qelinë, se në fakt do të shkosh! Ta them se do të shkosh. Të them zgjidhe qelinë, se hajdut tokash si ti, përveç Ramës...". - deklaroi z.Berisha.



DEKLARATAT

ALKET HYSENI

"Ja ku i kam dokumentet ku Flamur Noka, vëllai dhe fisi i vet nga Kukësi kanë marrë një pallat të tërë të të pastrehtëve në Sarandë dhe i bëj thirrje prokurorisë t'i hetojë", tha Hyseni.



ERVIN SALJANI

"Ndërsa ti Alket, i pari duhet të shkosh në burg zotëri. Reforma në drejtësi është që persona si ti dhe hajdutë me apo pa çizme të përfundoni në burg!", tha z.Saliانji.



"Kryeministrin e rrëzon nga pushteti rinia"

Kryemadhi, akuza Ramës: Nuk ke vënë kufje sot, por të paktën vër syzet

Kryetarja e LSI, Moni ka Kryemadhi, e quajti dje Edi Ramën më gjakatar se çdo pushtues tjetër që ka pasur në Shqipëri. Sipas saj, Rama ka një projekt të shesë Shqipërinë. Ajo ironizoi kryeministrin për mbajtjen e kufjeve në Kuvend dhe i sugjeroi që të vendosë syze për të parë dhe mjerimin që ka në Shqipëri. "Edhe pushtuesit më gjakatarë nuk kanë pasur këtë trajtim nga qeveria. Kjo qeveri ka një projekt, 'Shqipëria në shitje', pasi e ktheu në një vend me prodhimin me më të lartë. Kjo qeveri së shpejti do të jap dhe pacientët me koncesion, pasi me spitalët mbaroi, kjo qeveri i ka dhënë të gjitha me koncesion. Ujin po e paguajnë si naftë dhe naftën sikur të jenë danezë, qeveri po mbush vendim me kulla që po mbin si kërpudha. Kemi kryeministrin i cili e quan sukses depërtimin



e 10% të popullsisë. Kemi më shumë shitës sesa klientë. Edhe pse nuk ka vënë kufje, nuk ka veshë për të dëgjuar, por ai duhet të vendosë syze që të mos shikojë vetëm ato që shikon në 'Facebook', por të shikojë edhe mjerimin", tha zj.Kryemadhi. Ajo shtoi më tej se: "Të gjithë e dinë se Rama nuk ka kursyer askënd nga njerëzit e tij më të afërt, bashkëpunëtorë, e dinë që nuk ka kursyer as familjarët

e tij kur ka qenë fjala për të ruajtur karrigen. Ku e ke ish-ministrin që kanabizoi vendin, paratë e të cilit të sollën në pushtet. Në këtë sallë në krah ka njerëz milionerë, por që nuk justifikojnë dot as makinat me të cilat lëvizin. Ke njerëz që bëjnë jetë luksoze dhe i sheh në shoqërinë e banditëve dhe kriminelëve, por hesht, se i shërbejnë", tha Kryemadhi.

Haxhinasto: Taksa të përjashtojë banorët e zonës

Deputeti i LSI, Edmond Haxhinasto foli dje në Kuvend për vendimin e aplikimit të taksës për Rrugën e Kombit gjatë kohës që ka qenë ministër. Ish-ministri i Transporteve tha në Kuvend se taksa ishte vendosur mbi tarifën për kilometër dhe se do të ishte nën mesataren e rajonit. Haxhinasto nënvizoi se në dokumentet e konkurrimit shprehej qartë se banorët dhe qytetarët e zonës kanë qenë të përjashtuar nga taksa, ndërsa përdoruesit e shpesh të rrugës do të pajiseshin me abone. "Banorët kanë qenë të përjashtuar nga taksa, që përdoruesit e shpesh të rrugës të kenë abone, që do të thotë se tarifa nuk do të jetë kjo që është vendosur, por shumë më e ulët se kaq. Dua të theksoj edhe investimet që duheshin bërë, rruga e re e Kukësit, kthesa e re e Kukësit drejt Morinës dhe përmirësimi i gjithë skarpateve", tha Haxhinasto.



AKUZA

PETRIT VASILI

"I vetmi njeri i pozicionuar qartë në këtë vend, në orientimin e tij drejt ruajtjes së parave është kryeministri. Për fat të keq, ka një pozicion edhe të lig, edhe të shëmтуar, edhe shpërdorues, dhe po shkaktonte disa gropa që, për fat të keq, do na duhen shumë vite për t'i mbyllur, por do shërbejë edhe për të kujtuar një të keqe të madhe".



TARIFA

TAULANT BALLA

Kreu i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla, reagoi dje për tarifën e vendosur për automjetet që kalojnë në 'Rrugën e Kombit'. Ai e ftoi kreun e PD të bëjë kallëzim në prokurori, teksa tha se "afëra Durrës-Kukës nuk është mbyllur. Sa herë që flitet për rrugën Durrës-Kukës do të kujtohet edhe dëmi ekonomik që i ka shkaktuar papërgjegjshmëria e Bashës".



HETIMI

EDI PALOKA

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, paralajmëroi se ka fakte të reja për arrestimin e ish-ministrit Tahiri, ndaj dhe prokuroria sipas tij duhet të kërkojë këtë gjë. Ai akuzoi se Rama urdhëroi bllokimin e drejtësisë. "Prokuroria duhet të rikërkojë arrestimin e Tahirit dhe të gjithë atyre që rezultojnë në lidhjet kriminale Habilaj-Tahiri", - tha Paloka.



Replikat në Kuvend, kreu i PD: Një ministër i çoi banditë biznesmenit në emër të Rusisë

Rama: S'ju ndalojmë dot të thyeni qafën. Basha: Llapaqen batutash

"Financimi rus? Të nisim komisionin hetimor"

Valentina Madani

Tarifa për Rrugën e Kombit përplasi dje mazhorancën dhe opozitën në Kuvend. Palët akuzuan njëra-tjetrën ndërkohë që Kryeministri Rama u kujtoi demokratëve se mirëmbajtja e kësaj rruge përmes taksimit ishte një nismë e qeverisë Berisha. Për Lulzim Bashën vendosja e kësaj takse është grabitje e dyfishtë që i bëhet shqiptarëve. "Në 5 vite e ka rritur dy herë taksën e qarkullimit. Nga ne e gjete 7 lekë për litër, e bëre 240 lekë për litër. Ti u merr shqiptarëve për 500 mijë tonë 120 milionë dollarë në vit. Pse s'të mjaftojnë ty që të paguash mirëmbajtësin e rrugës. Çfarë bën ti? Ti këto para i bën rrush e kumbulla. Ti sot i takson shqiptarët dyfish", - theksoi z.Basha. Kryeministri Rama iu përgjigj akuzave të opozitës për pagesën në 'Rrugën e Kombit', duke e cilësuar gjithë sa po ndodh, flamur të një patriotizmi të rrekosur, pasi si ka thënë ai, jemi i vetmi vend në Evropë që i ka rrugët pa pagesë. "E dimë historinë, i dimë dhe të pandehurit që janë në sallë, dimë dhe shumë bëma, kjo rrugë është e papërfunduar, pa studimet e nevojshme gjeologjike. Formulë rrumpalle, që ju bëtë sa herë ju është dhënë mundësia të merrni në dorë çelësat e shtetit. Përgjigja që ka qenë mësim për ne është, nuk ekziston në asnjë vend të planetit një teori që përjashton banorët si teori nga detyrimet pasi ata janë përdoruesit. Me atë avaz po shkoni kokëposhtë, ne nuk ju ndalojmë dot që të thyeni qafën për aty ku jeni



KËRCËNIMI

Kreu i PD-së tha se një ministër i Ramës i ka dërguar banditë dhe ka kërcënuar një biznesmen shqiptaro-amerikan. "Nëse prokuroria nuk do të ishte e kapur nga ty, duhet të kishte hapur hetim për një ministër tënd që krekoset aty, që i ka nisur banditë në emër të 'Juremexit' dhe të Rusisë, një investitor shqiptaro-amerikan" - theksoi z.Basha.

Ish-kryeministri: Asgjë s'kam të fshehtë

Berisha: Unë dhe Olldashi nuk vendosëm taksë në Rrugën e Kombit

Ish-kryeministri Berisha lironi dje se pagesa në 'Rrugën e Kombit' ishte ideja e tij, duke sqaruar se për këtë ai bëri një studim së bashku me ministrin e asaj kohe, Sokol Olldashi, dhe vendosi që taksë të mos vihej zbatim. "Është e vërtetë që në 2011 qeveria e kryesuar nga unë dhe me ministër të ndjerin Sokol Olldashin, bëmë të gjitha studimet dhe asgjë s'ka të fshehtë. Është po kaq e vërtetë që pas studimit u vendos që taksë të mos vihet. Vazhdojmë pak më tutje, a jam unë kundër fondeve për mirëmbajtjen e rrugëve? Në asnjë mënyrë! Përkundrazi, sado fond të sillni në parlament unë do t'i votoj, sepse është jetike. Por të caktosh



5 mln dollarë për mirëmbajtjen e rrugëve që janë 18 mijë km në mbarë vendin do të thotë se nuk jeton në këtë vend. Kthehemi prap tek taksë. Doli vlera, ishte e papranueshme. U vendos, jo ta mirëmbajë drejtorja e rrugëve, kurrë! Unë jam dhe do jem që mirëmbajtja e rrugëve t'u jepet kompanive private, të cilat kanë fuqi disa herë më të madhe, ekspertizë kanë sesa drejtorja e rrugëve. Po kush ishte dallimi? Dallimi ishte thelbësor. Do t'i jepnim koncesionarit, siç i jepni ju ndrikull Nushit, ne do jepnim paratë për të mirëmbajtur Rrugën e Kombit, rrugën Tiranë-Durrës, rrugën Durrës-Pier, Pier-Vlorë e me radhë", theksoi z.Berisha.



Gjikhuri: Abone për mjetet që udhëtojnë shpesh

Ahmetaj, PD-së: Budallallëqe, tarifa dhe taksa janë të ndryshme

Ministri i Energjetikës dhe Infrastrukturës Dami Gjikhuri deklaroi dje në Kuvend se aplikimi i tarifës për rrugën e Kombit është diskutuar që në kohën e qeverisjes së demokratëve. Ndërsa sa i përket diskutimit për tarifën 5 euro, ministri theksoi se nëse do të vendosej një kuotë më e vogël, nuk do të mbulonte investimet e bëra për mirëmbajtjen e Rrugës së Kombit. "Për ata mjete që udhëtojnë shpesh do të ketë një abone me çmim të reduktuar, p.sh. për një periudhë 6 mujore. Në tre vitet e para janë parashikuar pagesa në favor të shtetit", - tha Gjikhuri. Kurse Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, u shpreh se tarifa dhe taksa e qarkullimit janë gjëra të ndryshme, pasi secila kanë destinacione të ndryshme. "Tarifën e rrugës e ke iniciuar ti, z.Berisha me vendim qeverie, në bazë të një studimi që e kemi përdorur dhe ne. Taksa është në thesin e madh, pse flisni budallallëqe, dhe thoni që është për mirëmbajtjen. Taksa shkon në buxhetin e shtetit, nuk ka destinacion specifik. Tarifa është me destinacion specifik, dhe është e thënë qartë që shkon për mirëmbajtje", - deklaroi Ahmetaj.

paqen i batutave me këtë sistem që ke shpikur tani pse paguajnë edhe taksapaguesit edhe përdoruesit?! se vazhdon t'u marrësh shqiptarëve 240 lekë litër karburanti dhe pastaj iu vendos edhe tarifë për rrugët ku udhëtojnë. Sapo e the vetë o njëra, o tjetra. Sapo e the vetë para shqiptarëve dhe nuk të shpëton ngërdheshja, ngërdheshja tregon para shqiptarëve sa i pacipë je, se duhet të ulje kokën ose t'i kërcisje ndonjë shpullë atij që të gënjeu, mësuesit të anglishtes. Ti flet për estetikë të Partisë Demokratike që e ke kthyer partinë tënde në një bodrum të llumit të krim-it të organizuar", - theksoi kreu i PD-së.

Pakti Greqi-Shqipëri, ministrat e Jashtëm diskutojnë hapat e mëtejshëm

Kotzias, takim 3 orë në Tiranë me Bushatin, çelen negociatat teknike

Bushati: Firmosa plotfuqishmërinë, Tsipras vjen në verë



RUSIA

"Marrëdhëniet tona kanë vite që nuk po ngrihen dot dhe janë në një lloj pike shumë të ulët, qoftë për sa u përket këndshikimeve diametralisht të ndryshme për zhvillimet në Ballkan dhe sidomos qëndrimin refraktar të Moskës dhe në disa raste paragjykes ndaj rolit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në Ballkan", vlerësoi dje Bushati.

planifikuar në pranverë. Ai tha se nga pala greke nuk ka pasur asnjë kërcënim, duke hedhur poshtë edhe pretendimet e kreu të PDIU së Kotzias kishte thënë se do çohet nga tryeza, nëse flitej për Camërinë.

MEDIA GREKE

Qëndrimi disa orësh në Tiranë i ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias, është përcjellë me vëmendje edhe nga mediat e Greqisë fqinje. Portalet kryesore të vendit kanë publikuar deklaratën e

përbashkët të dy Ministrave të Jashtëm, që përgjithësisht është përcjellë me tituj si "Kotzias e Bushati diskutojnë hapat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe", "Kotzias-Bushati, drejt zgjidhjes reciprokisht të pranueshme", "Në fokus, hapat e ardhshëm për çështjet me Shqipërinë". Vetëm portali i njohur Huffingtonpost.gr, del disi jashtë kornizës, duke shtuar se dy ministrat kanë diskutuar edhe për çështjen e detit.

Darina Tanushi

Ministrat e Jashtëm të Shqipërisë dhe Greqisë u takuan dje, për rreth tre orë, në Ministrinë e Jashtëm shqiptare. Në vijim të bisedimeve mes dy ministrave Ditmir Bushati dhe Nikos Kotzias, takimi i djeshëm shënoi edhe nisjen zyrtare të bisedimeve teknike, pas dhënies së autorizimit nga Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Kotzias qëndroi 3 orë në Tiranë, përgjatë rrugës për të shkuar në Vjenë, ku është takuar me homologun maqedonas. Në pritjen që iu bë Kotziasit në Ministrinë e Jashtëm u vu re një klimë mjaft miqësore. Të dy ministrat janë takuar dhe përfunduar me njëri-tjetrin, duke lënë të kuptohet se gjatë këtyre takimeve të shpeshta kanë krijuar edhe një lloj miqësie personale. Pas takimit të dy Ministrat e Jashtëm kanë dalë me deklaratë të përbashkët rreth asaj çfarë është biseduar. Në njoftim thuhet se dy kryediplotmatët shqyrtuan progresin e shënuar prej takimit të janarit të mbajtur në Korçë që është materializuar në një sërë zhvillimesh pozitive tashmë të bëra publike nga palët. Bushati dhe Kotzias u dakordësuan për hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren në muajt e ardhshëm në funksion të avancimit të procesit dhe gjetjes së zgjidhjeve të mirëpranuara për çështjet ende në diskutim. Dy ministrat mësohet se i kushtuan një vëmendje të posaçme punës në proces për finalizimin e Dokumentit të Partneritetit Strategjik në përputhje me vullnetin e palëve për të forcuar dimensionin evropian të marrëdhënieve shqiptaro-greke. Ndërkaq ende nuk dihet saktësisht se çfarë u bisedua tjetër në këtë bisedë të gjatë dhe po ashtu nuk është deklaruar një datë për ardhjen në Shqipëri të kryeministrit grek, Alexis Tsipras, i cili së bashku me kryeministrin Edi Rama do të firmosin marrëveshjen e re, në rast se do të arrihet një e tillë në bisedimet teknike. Vonesa me dhënien e autorizimit nga presidenti Meta shqyrtu dhe vizitën e kryeministrit grek, Alexis Tsipras në Tiranë, e cila ishte parashikuar brenda prillit. Pas vizitës në Tiranë, Kotzias shkoi në Vjenë, ku sot do të takohet me homologun maqedonas Nikol-

la Dimitrov dhe negociatorin e OKB-së për çështjen e emrit, Matzhev Nimetz. **DEKLARATA** Përpara takimit me ministrin e Jashtëm grek, Nikos

Kotzias, kreu i diplomacisë shqiptare Ditmir Bushati tha se ka firmosur plotfuqishmërinë për grupin negociator. Ministri i Jashtëm, Bushati, tha pas takimit, në një

intervistë për "Ora News": "Jam optimist që 2018-ta do të mund të shënohet edhe si një vit i adresimit të çështjeve të mbartura me Greqinë, sepse është bërë një punë voluminoze në këtë drejtim. Mendoj se janë pjekur kushtet në të dyja vendet për të ecur me vendosmëri përpara. Natyrisht, do të na duhet punë për të eliminuar apo për të evituar të gjithë atë retorikë apo lajme si ai që më pyetët pak më parë që nuk ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve dhe mendoj se nuk ka asnjë arsye për të qenë pesimist që 2018-ta të jetë një vit ku marrëdhëniet shqiptaro-greke, të njohin një fazë të re të zhvillimit të tyre", tha ai. Bushati foli për një takim të mundshëm të kryeministrit grek në Shqipëri gjatë verës, një vizitë kjo e shtyrë, pasi ishte



Kreu i PDIU reagon ashpër pas vizitës së ministrit grek

Idrizi: Kotzias i kërkoi Bushatit të mos përmendej Çamëria se do çohet nga tavolina

Kryetari i Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi reagoi dje, pas takimit të dy ministrave të Jashtëm të Greqisë dhe të Shqipërisë. Sipas tij, "në takimin që është zhvilluar mes ministrave të jashtëm të Shqipërisë dhe Greqisë, në tavolinën e diskutimeve, sipas mediave, Kotzias ka kërkuar që të mos përmendet Çamëria në të kundërt ai do të çohet nga tavolina. Nëse ky lajm është i vërtetë po ju kujtoj, që çështja çame është dhe mbështet me dokumente detyruese dhe jo çështje dëshirash për shtetin shqiptar". Idrizi u shpreh se "çështja e shqiptarëve të Çamërisë mbështetet mbi ligjin e parlamentit të Shqipërisë të vitit 1994, që e njeh 27 qershorin si ditën e gjenocidit mbi shqiptarët e Çamërisë dhe Rezoluta për çështjen Çame". "Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet është për dialog dhe për zgjidhje në tavolinë, por po të ishte për të çuar nga tavolina, duhet që çohet Bushati, që për sa kohë Greqia nuk ka hequr



ligjin e luftës me Shqipërinë, duhet të mos ulej në tavolinë me një vend që mban në fuqi ligjin e luftës me Shqipërinë", deklaroi kreu i PDIU-së, Idrizi. Disa

herë, gjatë bisedimeve me Kotzias-Bushati, kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi ka ngritur zërin për trajtimin e çështjes çame, si pjesë e bisedimeve.

NEGOCIATAT

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati lajmëroi dje, se kryeministri grek mund të vijë gjatë verës për firmosjen e marrëveshjes së re, ndërsa nisja e negociatave është thjesht çështje ditësh. "Duke qenë se po i afrohem periudhës së Pashkëve, është thjesht çështje ditësh dhe kemi punuar për një kalendar se kur dhe ku do të mblihdhen apo ku do zhvillohen takimet", tha Bushati.



Meta me ambasadorët e Portugalisë e Danimarkës: Mbështetje për në BE

Presidenti i Republikës, Ilir Meta pranoi dje, Letrat Kredenciale nga ambasadorët e rinj të Portugalisë dhe Danimarkës në vendin tonë. Në takimin me ambasadorin e ri të Portugalisë, Francisco Maria de Sousa Rebeiro Telles, presidenti Meta vlerësoi nivelin e mirë të bashkëpunimit politik dypalësh dhe theksoi nevojën e nxitjes së mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik e tregtar midis dy vendeve. Në mënyrë të veçantë Presidenti Meta u ndal në mundësinë e bashkëpunimit në fushën e turizmit, ku vlerësoi ekspertizën shumë të kualifikuar të Portugalisë në drejtim të arsimit e trajnimit profesional në industrinë e turizmit. Presidenti Meta shprehu gjithashtu mirënjohjen për mbështetjen e dhënë nga Portugalia në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe besimin se kjo mbështetje nuk do të mungojë edhe për çeljen e negociatave të anëtarësimit brenda vitit 2018. Edhe në takimin me ambasadorin e Danimarkës, Liselotte Plesner, Meta vlerësoi gjithashtu edhe rolin dhe mbështetjen e Danimarkës për procesin e integritimit evropian të Shqipërisë dhe për vijimin e procesit të zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin për shijen e pasurisë së palajshme "Apartment" me Nr. Pasurisë 4747-17, Zona Kadestrale 9210, Vll.4, Faze 169, me sip. 63 m². ndodhur në Tiranë, Rr.Kongresi i Parmetit, Pall.85, Shk.1, Ap.7, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorës Valbona Janiti, në shumën 3'156'480 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërdjetë e tetëdhjetë) lekë. Çmimi fillues me të cilin fillon ankandi është në shumën 6'480'000 (gjashtë milion e katërdjetë e tetëdhjetë mijë) lekë, e përcaktuar në vendim gjyqësor. Ankandi zhvillohet në datë 11.04.2018, ora 16:00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Qendra Torre Drin, K.L2, Nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471,0684054605, email : ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

SHPALLJE (PËR SHITJEN E SENDIT TË PALLUAJTSHËM NË ANKAND)

ME DATE 13.04.2018 NGA ORA 8:00 – 16:00, PRANE KESAJ ZYRE PERMBARIMORE DO TE ZHVILLOHET ANKANDI PER SHITJEN E APARTAMENTIT ME SIFERACE 80.25 R2.NR. PASURIE 46/205ND-1-56, ZK 8518, Vll.4 I VENOSUR NE DURRES L. 13 PLAZH, NE PRONESI TE SHOQERISE SIAC SH.P.K. CMIMI FILLESTAR PER ÇELJEN E ANKANDIT TE I RE ESHTE 3.389.760 LEKE. Te interesurit te paraqiten prane zyres permbarimore A.D.R. Permbarues Gjyqësor Dorian Zazani, ne adresen : Durres,lnr 2, rr. A.Goga, ose te kontaktojne ne nr. tel: 0672586883

Drejtori i ALUIZNI-t shpjegon vendimin për bllokimin e regjistrimit të titujve të pronësisë

Ligji 7501, Lame: Ja si do të zgjidhen "mbivendosjet"

Ornela Manjani

Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame, shpjegon vendimin e qeverisë për bllokimin e përkohshëm të regjistrimit të titujve të pronësisë në bregdet. Lame ka bërë të ditur se pezullimi i regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi në bazë të Ligjit 7501 nuk do të prekë tokat bujqësore. Kreu i ALUIZNI-t ka shpjeguar edhe faktin se si do të veprohet në rastet e "mbivendosjes", që do të thotë rastet kur toka është shitur e rishitur. Në një intervistë për "ERTV", Lame shpjegon të gjithë procedurën që do të ndiqet për verifikimin e titujve.

Qeveria ka marrë vendimin për pezullimin e titujve të pronësisë në bregdet për të gjithë titujt e lëshuar. A duhet marrë në herët ky vendim. Pse pikërisht tani?

Sikur ky vendim të ishte marrë para 10 vjetësh nga cilado qeveri, dëmi do të kishte qenë shumë më i vogël. Sikur ta kishte marrë para 5 vjetësh, dëmi do të kishte qenë disa më i vogël; sikur të ishte marrë pas 5 vjetësh, do kishte marrë fund çdo gjë. Në çdo moment që merret ky vendim është në të mirë të vendit, të pronarëve të ligjshëm, në të mirë të investimeve dhe në të mirë të atyre që kanë bërë të ligat në këtë vend. Thelbi i atij vendimi është ky, që në zonën bregdetare të vendit nga Buna deri në Kepin e Stillos të pezullojmë regjistrimin në hipoteka në titujve të pronësisë të dhëna me Ligjin 7501 dhe të bëjmë një verifikim të tyre. Të gjitha instancat që duhet të filtrojnë në këto 20 vjet, sepse problematikat e Ligjit 7501 kanë nisur pas vitit 2000, pasi mbaroi çfarë duhej ndarë vërtetë dhe filluan të ndaheshin ato që nuk duheshin ndarë. Filtrat që ishin krijuar për të kontrolluar nuk kanë funksionuar. Filtri i fundit është hipoteka, e cila ka diva vjet që jep sinjalin që ka probleme. Në një moment kjo u bë aq e dukshme në raportet brenda hipotekës dhe nga auditet e qeverisë, edhe nga goditja që kanë dhënë organet ligjzbatuese. U bë aq e madhe, sa askush nuk mund të mbyllte më sytë.

Ju keni deklaruar se i gjithë bregdeti është i parregjistruar?

Arsyeja ka qenë shumë e thjeshtë pse është lënë bregdeti pa regjistruar, më tepër se 2/3 bregdetit është e parregjistruar dhe kjo është lënë pa regjistruar për të

bërë të mundur masakrën me pronën në bregdet. Kjo zonë është lënë jashtë sistemit.

Sa do të zgjasë procedura dhe sa është garant qeveria se nuk do të pengohen pronarët e ligjshëm?

Në Shqipëri ligji nuk është me garancë, për një arsye të thjeshtë në rastin konkret. Sepse kemi një ligj për verifikimin e AMTP-ve të miratuar në 2008. Ligji ishte, por është lënë atje dhe është bërë ç'është dashur. Në rastin konkret është një dëshirë dhe vullnet i qeverisë që vendosi që përtej avancimit me ligj, edhe prefektët janë në proces pune. U bë edhe bllokimi në hipotekë i regjistrimit për t'i dalë para, përpara se dëmi të ketë kaluar edhe filtrin e fundit. Nuk mjaftojnë ligjet me sistemin



Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame

ligjor problematik, por nuk që edhe vullneti politik për ta bërë. Ishte vullneti i qeverisë që kërkoi këtë gjë më ngulm. Garantoj njerëzit se fasha bregdetare që është

të përgzjedhur për t'iu nënshtruar kontrollit është detajuar me aq saktësi dhe me aq "bisturi" pikërisht për të ndarë zonën e brendshme të vendit, ku fermerët kanë

marrë tokën reale dhe punojnë dhe mbajnë familjen, atyre s'do u ndodhë asgjë nga fasha bregdetare që është marrë me të padrejtë.

PD e cilëson antikush-tetues vendimin për pezullimin e VKM-së. Si e koment në lidhje me deklaratën?

Ne kemi hequr asnjë titull pronësie. VKM-ja thotë se kemi një ligj për dhënie pronësie dhe ky ligj zbatohet proceduralisht nëpërmjet një vendimi qeverie, që përcakton cilat janë procedurat për të marrë një titull pronësie. VKM-ja që nxori qeveria thotë se në këtë VKM-në zbatuese pezullohet përkohësisht zbatimi i saj sa të bëjë verifikimet. Nuk është ndryshuar ligji me VKM, por është pezulluar veprimi i VKM-së për një

moment, askujt nuk i është hequr titulli i pronësisë. Vetë qeveria paraardhëse beri një ligj për verifikimin e titujve të pronësisë në 2008. Nuk funksionoi për dy arsye, politike dhe teknike, që e bënë për të gjithë Shqipërisë, se nuk vlenë. Ne merremi vetëm me bregdetin.

Çdo të ndodhë me ata që i kanë blerë këto toka në bregdet?

Kush ka blerë në kushtet e mirëbesimit i cili është një term juridik dhe e sqaron Kodi Civil, që do të thotë se në rast se ke blerë një send ose tokë në mirëbesim, atëherë sendi i jepet të zotit real dhe t'i do të marrësh para, apo do të të kthehet. Po nuk është kjo thjesht zgjidha. Do komportojmë një numër gjyqesh dhe aktesh të ndërmjetme, ka njerëz që e kanë riberelë ose ndërtuar. Përgjegjësi do të mbajnë ata që e kanë bërë të parët aktin.

Birra e importit "gjunjëzon" prodhimin vendës

Bregasi: Kërkojmë balancim të akcizës me Kosovën

që ka industria vendëse e prodhimit të birrës e avantazhon produktet e huaja në Shqipëri. Kosova e ka pasur 3 euro për litër për gradë alkool dhe e ka bërë tashmë 8 euro për litër për gradë alkool, kur ne dmth., e kemi gati 1 euro për litër për gradë alkool.



Luan Bregasi

ool. Kjo është një nga arsyt kryesore që kanë vështirësuar konkurrencën e prodhimeve shqiptare në Shqipëri", deklaroi Bregasi. Por, një rëndësi tjetër për industrinë e birrës janë edhe disa taksa të mbetura që nga viti 2012, të cilat rëndojnë

akoma më shumë kostot e prodhimit vendës. "Industria e birrës nuk është në një situatë komode dmth., në kuptimin e kushteve të punës dhe nuk është në një situatë konkurruese për sa u përket produkteve të importit dhe prodhimit vendës, kjo për arsye sepse kostot e prodhimit vendës rëndohen në mënyrë jo korrekte nga disa taksa që kanë mbetur dhe e rëndojnë këtë prodhim nga e kaluara, siç është taksa e pullës fiskale, e cila po nga Kosovën që është 3 euro për 1 mijë shishe, ndërsa në Shqipëri është 28 euro për 1 mijë shishe. Janë kostot e ambalazhit, siç është akciza e qelqit dhe ajo e akcizës e plastikës, të cilat kanë mbetur për të mbushur buxhetin e shtetit që në 2012 dhe rëndojnë padrejtësisht kostot e industrisë së prodhimit vendës. Po kështu, një arsye tjetër është kostoja e lartë e energjisë elektrike. Kemi qmimin më të lartë në rajon, rreth 2.5 më shumë. Pra, janë disa faktorë që realisht e kanë rënduar koston e produktit vendës dhe e kanë vënë shumë në vështirësi industrinë e birrës, e cila është një industri që ka investuar 80 mln euro dhe ka të punësuar në sistemin e vet më shumë se 30 mijë njerëz. Këto janë arsytet që e kanë bërë industrinë e birrës të mos jetë më konkurrenë përballë birrave që importohen në Shqipëri", shprehet Bregasi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,604,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **24 Prill 2018, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

“DIPLOMATICUS” INTERVISTA

Intervista në “News 24”/ “Qëllimi, vëllimi tregtar të arrijë shifrën 1 miliard euro”

Ambasadori i Turqisë: Aeroporti i Vlorës shpërthen turizmin në vend

“Synojmë 50 mijë të punësuar në kompanitë turke”



Murat Ahmet Yoruk, ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë

Erion Kaçorri

Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yoruk, e konsideroi si nder emërimit të tij në këtë detyrë të re në Shqipëri. Në një intervistë për emisionin “Diplomaticus” në “News 24”, diplomati turk flet për mundësinë e thellimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, ndërtimit e aeroportit të Vlorës dhe përmirimit e organizatës FETO në vendin tonë.

Z. ambasador, ju e keni marrë zyrarisht detyrën në janar. Besoj gjatë kësaj periudhe duhet të keni pasur rastin ta vizitoni Shqipërinë. Si po ndjeheni këtu?

Dëshiroj të theksoj se për mua është një nder dhe përgjegjësi e madhe të jem ambasador i Turqisë në një vend mik dhe vëlla, ku jam emëruar me miratimin e Presidentit tonë, zotit Recep Tayyip Erdoğan dhe të qeverisë sonë.

Pak kohë pas shpalljes së Republikës së Turqisë, brenda vitit 1923, ne hartuam “Marrëveshjen e Përfundimit të Miqësisë dhe të Bashkëpunimit” me disa vende, njëri nga të cilët ishte Shqipëria, të cilën ne e vlerësojmë si fqinje të zemrës. Unë dëshiroj ta vizitoj të gjithë këtë vend të bukur, me bukuri të rralla natyrore në Evropë dhe në Mesdhe. Të gjitha qytetet ku banojmë njerëz simpatikë, të gjitha krahinat nga Korça në Dibër, nga Saranda në Kukës, nga Mirdita në Berat, nga Vlora në Delvinë. Dëshiroj të takohem me vëllezërit tanë shqiptarë. Ndonëse detyrën time këtu e kam filluar në muajin janar, deri tani kam vizituar qytetet më të bukura të Shqipërisë dhe të Ballkanit, siç janë Elbasani, Durrësi dhe Shkodra, qytete me bukuri natyrore, me vlera njerëzore dhe kulturore. Kam mbetur i habitur nga këto qytete me civilizim dhe personalitet të lartë, njëri më i ndryshëm nga tjetri. U bëra dëshmitar i faktit se sa ngjajnë me njëra-tjetrën kultura shqiptare dhe kultura turke.



Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë, Murat Ahmet Yoruk gjatë intervistës me gazetarin, Erion Kaçorri

Udhëtimin e parë në Shqipëri jashë Tiranës e bëra më 1 shkurt 2018 në Belsh, në këtë qytet të bukur buzë liqenit dhe në Elbasan. Në Belsh bashkë me kryetarin e bashkisë, deputetët e Elbasanit, prefektin e Elbasanit, banorët dhe fëmijët e zonës morëm pjesë në ceremoninë e përmirimit të kopshtit, i cili u rikonstruktua dhe u pajis me mobilie falë ndihmës së vendit tonë. Ndërkaq, dëshiroj të kujtoj se ka qenë elbasanas Sedefqar Mehmeti (Sedefqar Mehmet Aga), arkitekti i Xhamisë Sulltan Ahmet, ose e njohur edhe si Xhamia Blu, e cila është një ndër xhamitë më të bukura të Stambollit, madje edhe të botës. Ai është një ndër arkitektët gjenialë të rëndësishëm, që përgatiti arkitekt Sinani. Në kohën e tij u ndërjuan vepra tepër të veçanta. Nga burimet historike dihet se Sedefqar Mehmet Aga në kohën e tij ndërtoi xhami, hamame dhe çezme me emrin e tij. Por fatkeqësisht këto vepra historike, që ishin pasuri e Shqipërisë, bashkë me shumë vepra të tjera historike në të gjithë vendin u shkatërruan pa mëshirë në periudhën e Enver Hoxhës.

Përshtypje të mëdha më ngjallën edhe dy vizita në qytetin e Shkodrës, ku ndodhet monumenti i Hasan Riza Pashës, mbrojtësit të Shkodrës dhe heroit tonë të përbashkët. Ky monument është i vetmi objekt i kushtuar

dëshmorëve turq në Shqipëri. Gjatë vizitës sime të parë në Shkodër, bashkë me zëvendëskryeministren Senida Mesi vizitova Xhaminë e Plumbit, e cila është një ndër veprat historike më impresionuese në Shkodër dhe vazhdon të rezistojë me gjithë përmbytjet që ndodhin prej shumë vitesh. Ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën, bashkë me zonjën Mesi u dhamë shkodrënëve siharin që drejtoira e Përgjithshme e Vakëfëve të Turqisë ka marrë përsipër projektin për restaurimin e Xhamisë së Plumbit dhe për ruajtjen e saj nga përmbytjet e mundshme. Meqenëse po flasim për përmbytjet, jemi në dijeni se reshjet e shumta që po vazhdojnë prej dy javësh kanë shkakuar fryrje të lumënve dhe përmbytje në rajonin e Shkodrës në veri të vendit. Për të mbështetur likuidimin e dëmtimeve të shaktuara nga përmbytjet, unë jam në kontakt dhe në bashkëpunim të ngushtë si me zëvendëskryeministren, zonjën Senida Mesi, edhe me kryetaren e Bashkisë së Shkodrës, zonjën Voltana Ademi. Ashtu siç ka ndodhur gjithmonë, edhe vëllezërve tanë shkodrënë u zgjatim dorën e ndihmës, si shprehje e frymës së solidaritetit midis Turqisë dhe Shqipërisë. Më datë 24 mars, ne u dërguam familjeve të lënduara 50 tonë ushqime për bagëtitë dhe paketa ushqimore për 2500 persona. Bash-

kë me ekipin tonë të TIKAs në Tiranë, unë isha në Shkodër për shpërndarjen e ndihmave. Ne si Republikë e Turqisë jemi të gatshëm me sa kemi mundësi që t'u japin çdo lloj mbështetjeje vëllezërve tanë shqiptarë, kur ndodhen në ditë të vështira. Edhe në të ardhmen, unë do të vizitoj qytetet të tjera për t'u njohur me administratën lokale, për të realizuar veprimtari të përbashkëta kulturore me ta, për të studiuar fushat e bashkëpunimit ekonomik, për të parë mundësitë që ata u ofrojnë investitorëve tanë, me fjalë të tjera për të gjetur mundësitë se si do të mund të kontribuojmë për punësimin dhe mirëqenien e banorëve të këtyre qyteteve.

Si ambasador i ri i Republikës Turke, cilat do të jenë disa nga prioritetet e punës suaj në Shqipëri? Çfarë do të jetë në fokusin tuaj?

Falë lidhësive dhe vullnetit politik të Presidentit tonë, zotit Recep Tayyip Erdoğan dhe kryeministrit tuaj, zotit Edi Rama, të cilët u takuan para disa ditësh në Stamboll, unë fillova të ndërtime duke pasur si objektiv të çoj në nivele më të larta, të diversifikoj dhe të thelloj marrëdhëniet tona të përkryera midis vendeve tona në fushat politike, ekonomike-tregtare, kulturore, ushtarake dhe në të gjitha fushat e tjera. Unë dhe të gjithë kolegët e mi të punës jemi shumë të vendo-

sur për t'i arritur këto objektiva. Megjithatë marrëdhëniet tona janë të përkryera, marrëdhëniet ekonomike-tregtare midis të dy vendeve nuk pasqyrojnë potencialin e tyre të vërtetë. Ne dëshirojmë që investimet e sotme në Shqipëri me vlerë 2,7 miliardë dollarë t'i diversifikojmë dhe të thellojmë projekte konkrete dhe vizionare që do të kontribuojnë për mirëqenien dhe punësimin e të dy vendeve. Ne synojmë që vëllimin e tanishëm tregtar me Shqipërinë nga 460 milionë euro të shkojë në një miliard euro, numri i shoqërive me kapital turk nga 400, në dyfishin e kësaj shifre dhe numri i të punësuarve në kompanitë turke nga 11.000 në 50.000 persona. Në këtë mënyrë, ne kemi për qëllim të kontribuojmë për fuqizimin e ekonomisë shqiptare, rritjen e punësimit dhe të mirëqenies së shqiptarëve. Gjithashtu, unë dëshiroj sinjershtetësi që marrëdhëniet dhe kontaktet tona kulturore me rrënjë të thella në shekuj t'i forcojmë me veprimtari kulturore reciproke dhe të nxjerrim më shumë në pah aspektet tona të përbashkëta, që me të vërtetë janë shumë. Nuk kam dyshim se të gjitha këto përpjesë që kemi do t'i konkretizojmë me më shumë efektivitet falë projekteve dhe punëve që do t'i realizojmë së bashku me institucionet tona, siç janë TIKA dhe instituti “Junus Emre”. Unë synoj që vëllezërve tanë shqiptarë, çdo muaj në Tiranë dhe në qytete të tjera t'u krijojmë mundësinë për të ndjekur veprimtari kulturore që do të ngjallin interes dhe do të pëlqehen prej tyre. Për shembull, me rastin e Festës së Sovranitetit Kombëtar dhe të Fëmijëve, që është festë zyrtare më 23 prill në vendin tonë, ne do të sjellim në Tiranë Orkestrën Simfonike të Fëmijëve të përbërë nga 70 vetë. Ata janë fëmijë të muzikantëve turq. Fëmijët e orkestrës sonë, bashkë me vëllezërit e tyre shqiptarë do të interpretojnë edhe këngë shqiptare të preferuara. Ftoj në këtë veprimtari, e cila do të jetë pa pagesë, të gjithë fëmijët e Tiranës dhe familjarët e tyre.

I keni shfrytëzuar këto pak muaj për të takuar zyrtarët më të lartë në vend. Cilat kanë qenë temat e diskutimit me ata?

Takimet që kam zhvilluar në kuadrin e vizitave të kurtëzisë me personalitete të larta politike dhe zyrtarë të nivelit të lartë të ekzekutivit, ashtu siç kam pritur, kanë kaluar në një atmosferë të përzemërt dhe miqësore, ku është folur për objektiva konkrete drejt bashkëpunimit. E kam ndier veten si në shtëpinë time, mes miqve dhe të afërmeve të mi. Pa dyshim që ambasadorët në Turqi dhe ambasadorët shqiptarë në Turqi gjithmonë kanë pasur një vend tepër të veçantë. Por, kjo na ngarkon me një përgjegjësi krejt të veçantë si mua, edhe ambasadorin tuaj në Ankara, mikun tim Genti Gazheli. Motivimi dhe energjia pozitive që kanë shprehur bashkëbiseduesit e mi, për të cilët kam vërejtur se janë të hapur ndaj bashkëpunimit, siguria dhe mirësia që ndjen opinioni publik shqiptar për vendin tonë, tregojnë se ato që kemi bërë deri tani nuk janë të mjaftueshme dhe se ne duhet të punojmë edhe më shumë. Ndonjëherë mua dhe ekipit tim nuk i mjaftojnë 24 orët për të çuar më përpara këtë afërsi, që buron nga pozicioni i veçantë i marrëdhënieve midis dy vendeve tona dhe nga miqësia e privilegjuar mes popujve tanë. Ne e duam Shqipërinë, i duam shqiptarët. Mendoj se ato që bëjmë janë edhe më efektive, sepse burojnë nga thellësia e zemrës sonë dhe dashuria e sinqertë që ushqejmë për vëllezërit tanë shqiptarë.

Z. ambasador, Turqia konsiderohet një partner strategjik për Shqipërinë. Si shihet kjo në Ankara dhe në çfarë niveli dëshirojnë të shihni marrëdhëniet mes dy vendeve tona?

Ne e shikojmë Shqipërinë si një vend kyç për paqen, stabilitetin dhe qetësinë e Ballkanit dhe të Evropës. Ndjemi një kënaqësi të madhe që Shqipëria e ka shpallur vendin tonë si partner strategjik. Kjo është shprehje e asaj që dihet. Turqia dhe Shqipëria janë dy vende mike dhe vëllezër të



Ambasadori turk: Ato shkolla nuk mund të përdorin flamurin dhe simbolet turke

"Organizata terroriste FETO shtiu në dorë sektorin e arsimit në Shqipëri"

Murat Ahmet Yörüik: Janë të rrezikshëm për vendin

bestuar që mbështesin reciprokisht njëri-tjetrin, që zhvillojnë një bashkëpunim të ngushtë në fushat ekonomike, kulturore, shqetësores dhe çdo fushë tjetër. Në frymën e këtij besimi dhe mirëkuptimit reciprok, në dëshirë që marrëdhëniet tona të zhvillohen në mënyrë të shëndetshme me vizita të nivelit të lartë dhe teknike. Brenda këtij viti të marrin një dimension tjetër, duke u krijuar "Këshilli i Bashkëpunimit Strategjik të Nivelit të Lartë". Me fjalë të tjera, duke u organizuar mbledhje të përbashkëta të të dyja qeverive dhe nëpërmjet mekanizmave të drejtpërdrejta midis ministrive tona mbi baza sektoriale, në parashikim të i japim një vullsh bashkëpunim të tonë dhe të thellojmë atë.

Marrëdhëniet politike dhe kulturore duken mjaft të mira. Në nivelin e bashkëpunimit ekonomik, për shembull, duket se ka vend për më shumë punë. A e ndani këtë mendim?

Sic thashë edhe pak më parë, investitorët turq janë ndër investitorët më të mëdhenj në Shqipëri. Sipas IN-STAT-it, institutit zyrtar të statistikave në Shqipëri, në vitin 2017 vendi ynë ishte partneri i dytë më i madh importues i Shqipërisë. Por nëse do të kihen parasysh potencialet tona, këto nuk janë të mjaftueshme. Shqipëria është një vend ku mund të hapin dritaret e shanseve të mëdha në turizëm, energji, infrastrukturë, miniera, bujqësi dhe fusha të tjera, gjithmonë reciprokisht në të mirë të interesave të të dyja vendeve. Shqipëria është një vend edhe me një fuqi punëtore të re dhe të arsimuar, e cila mund t'i vërë në lëvizje këto pasuri. Fakti që të rinjtë tuaj njohin gjuhën turke është një avantazh shumë i rëndësishëm që ata të punojnë në kompanitë turke në Shqipëri. Këto burime dhe kapacitete njerëzore të Shqipërisë janë mundësi të rëndësishme për investitorët e mëdhenj të vendit tonë, i cili është ndër 20 vendet e para me ekonomi dinamike dhe më të zhvilluar në botë. Sipërmarrësit tanë që investojnë në Shqipëri,

njëlloj si unë, e ndiejnë veten si në shtëpinë e tyre. Që nga fillimi i detyrës sime, unë i inkurajoj investitorët tanë të rinj që të bëjnë investime në Shqipëri. Në të ardhmen, falë veprimtarive promovuese që do të organizojmë si në Shqipëri edhe në Turqi, si dhe me nxitjen e ambasadës sonë, ne do të synojmë të sjellim më shumë investitorë në Shqipëri. Unë kam pretendime në këtë fushë dhe të gjithë së bashku do t'ia dalim mbarë.

Prej disa muajsh, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka folur për një investim turk që ka të bëjë me aeroportin e Vlorës. Cfarë mund të dimë për investitorin dhe kur pritet të nisë puna për këtë vepër?

Shqipëria ka një potencial shumë të fuqishëm për turizëm. Por po të krahasohet me vendet përreth saj, pjesa e të ardhurave nga turizmi është shumë e ulët. Po të shikojmë bukuritë gjeografike, bregdetin e pastër dhe madhështor, pasuritë historike-kulturore të Shqipërisë, duket qartë se situata e lartpërmendur nuk është e drejtë për Shqipërinë. Sipas meje, Shqipëria është perla e papërpunuar e Mesdheut, Adriatikut dhe Ballkanit. Një nga pengesat më të mëdha për vënien në jetë të këtij potenciali në Shqipëri janë nevojat në fushën e transportit. Të gjithë e dimë se në vendet përreth Shqipërisë, madje në ishuj dhe qytete të vogla ka aeroporte. Për pasojë, natyrisht që kjo ecuri nuk do të vazhdojë pafundësisht për Shqipërinë. Duket qartë se duhet filluar diku. Në përfundim të studimeve shkencore për fizibilitetin, në përcaktim se pika më e përshtatshme për një fillim të tillë është Vlora. Vlora është një pikë kryqëzimi për turizmin dhe qyteti me ndoshta bregdetin më të bukur në Ballkan. Ne e dimë se aeroporti që do të ndërtohet në Vlorë do të luajë rolin e dinamos në shpërbërjen e turizmit në vend. Aeroporti i Vlorës është marrë përsipër nga një konsorci i fuqishëm turk, i përbërë nga tri kompani, i cili po ndërton aeroportin e ri të Stambollit, që do të jetë aeroporti më i madh në botë me një kapacitet prej 200 milionë udhëtarësh në vit. Këto kompani janë ndër kompanitë turke më profesioniste, që bëjnë punime të nivelit më të lartë në fushën e arkitekturës dhe të ndërtimit.

Nuk është e vështirë të parashikosh se ky projekt do të nxitë edhe projektet e tjera infrastrukturore dhe investimet në rajon dhe për pasojë do të luajë një rol serioz në zhvillimin e Shqipërisë. Në bashkëpunim me Qeverinë shqiptare, ne jemi të gatshëm edhe për të gjitha projektet e tjera infrastrukturore. Duke u eliminuar mangësitë infrastrukturore të Shqipërisë, ne dëshirojmë me gjithë zemër të luajmë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e saj. Edhe ne lumturohem kur vëllëzërit tanë shqiptarë kanë rrugë moderne, tunele, ura, hidrocentrale, spitale dhe shkolla. Ne besojmë se vëllëzërit tanë shqiptarë, që kanë duruar në vite pasojat traumatike të komunizmit dhe që kanë vuajtur shumë, meritojnë më të mirën.

A parashikohen projekte të tjera investimesh turke, për shembull në sektorin e arsimit?

Arsimi është një fushë tjetër që zë një vend të rëndësishëm në bashkëpunimin midis të dy vendeve. Fatkeqësisht, nënshprehë pas rënies së regjimit të egër komunist, që zgjati thuasje gjysmë shekulli në Shqipëri, organizata terroriste tradhtarë dhe e maskuar e quajtur FETO, kjo vegël e forcave globale, shtiu në dorë sektorin e arsimit në Shqipëri dhe ende vazhdon. Ju lutem nuk duhet të harroni se FETO, kur e shikon të arsyeshme dhe sipas udhëzimeve që merr, është një organizatë terroriste që mund të krijojë kaos politik në vendin ku ndodhet dhe të shkatërrtojë rendin kushtetues. Në këtë e jetuam në 15 korrik. Më 15 korrik 2016 në Turqi u rrëzuan të gjitha maskat e FETO-s atje ku zhvillonte veprimtarinë, në arsim, shëndetësi, financë dhe media. Trutë e shpëllëra nga organizata tradhtarë dhe e pamëshirshme vetëm brenda një natë masakruan 250 persona. Mijëra shtetas turq u plagosën, ose ngelën invalidë. Prandaj këto grupime pretendojnë se janë shkolla turke dhe që vepronin nën maskën e arsimit, nuk kanë asnjë lidhje me të qenit turk, me myslimanizmin dhe me ndonjë vlerë tjetër të shenjtë apo morale. Ata nuk mund të përdorin flamurin turk apo simbolet tjera turke as në Shqipëri dhe as në ndonjë vend tjetër ku ndodhen. Natyrisht që një ndër objektivat tanë përparësorë në Shqipëri është

që të sjellim këtu cilësinë arsimore të vendit tonë. Në këtë kuadër kemi filluar veprimet e nevojshme. Urojme që institucionet e vërteta arsimore turke, pa qëllime fitimi, të jenë pranë popullit mik e vëllë shqiptar. Nuk do të lejojmë që vëllëzërit tanë shqiptarë të kenë nevojë për institucionet arsimore të strukturës tradhtarë. Fondacioni Arsimor 'Maarif' i Turqisë, i krijuar me një ligj të posaçëm, ka hapur shumë shkolla në shumë vende të botës, përshirë Kosovën dhe ka realizuar një hap të rëndësishëm. Brenda një kohe shumë të shkurtër edhe në Shqipëri do të marrim një shkollë, e cila do të menaxhohet nga Fondacioni 'Maarif' i Turqisë. Kjo shkollë do të sigurojë një shërbim arsimor me cilësi të lartë, me standarde ndërkombëtare, e integruar me botën dhe e përshtatshme

YPG janë zgjatime në Siri të organizatës terroriste PKK, e cila është në listën e terrorit të Bashkimit Europian, SHBA-ve dhe NATO-s dhe bërë një kërcënim të hapur dhe të afërt ndaj sigurisë kombëtare të vendit tonë. Para se të fillonte operacioni 'Dega e Ullirit', qindra raketa nga pozicionet e PYD/YPG-së kanë qëlluar në kufijtë e vendit tonë, në qytetet, fshatrat dhe fshatrat ku banojnë shtetasit tanë. Fatkeqësisht, vetëm gjatë vitit 2017 si pasojë e këtyre sulmeve kanë humbur jetën me qindra shqiptarë turq. Edhe në fillim të operacionit sulmet e tyre me raketa shkakuan të vdekur dhe të plagosur në xhamitë dhe djepat e fëmijëve në Kilis, në Rejhanli. Madje, kampet e refugjatëve ku ndodhen civilët edhe brenda në Siri janë nën zjarrin dhe kërcënimet e PYD/YPG-së.

ashtu, është absurd pretendimi se operacioni 'Dega e Ullirit' ka dobësuar luftën kundër DAESH-it. Turqia është një ndër vendet ku organizata terroriste DAESH ka kryer më shumë aksione. Turqia është vendi që ka zhvilluar luftën më efektive, më të singërtë dhe më të vendosur kundër DAESH-it, është vendi që i ka dhënë goditjet më të mëdha DAESH-it. Dihet edhe numri i dëshmoreve tanë gjatë Operacionit Mburoja e Firatit. Gabimi kryesor që dobëson dhe dëmton luftën kundër terrorizmit është mbështetja nën maskën e luftës kundër organizatave terroriste DAESH, që u jepet organizatave terroriste PYD/YPG, zgjatime të PKK-së në rajon. Gabimi kryesor është se vendet, të cilat pretendojnë se janë aleatë dhe partnerë strategjike, ende nuk marrin në konsideratë shqetësimet dhe paralajmërimet e Turqisë. Sikur të mos mjaftonte kjo, ato duke ndjekur organizatën terroriste, bëhen vegla në veprimtarinë obshkurantise propagandistike të organizatave terroriste. Gjatë operacionit 'Dega e Ullirit' civilët nuk kanë pësuar dëme, asnjëherë nuk është penguar furnizimi i civilëve me ujë, ushqime, ilaçe dhe nevoja të tjera njerëzore. Jo vetëm që nuk ka penguar, por Turqia nëpërmjet Gjysmëhënës së Kuqe dhe Projektit të Emergjencave Civile ka mobilizuar të gjitha mundësitë e saj për të përballuar çdo nevojë të vëllëzërve tanë sirianë. Turqia e ka zhvilluar me sukses një operacion ushtarak pa dëmtoar civilët, pa djegur dhe pa prishur vendbanimet e tyre, pa shkaktoar shkatërrime në rajon. Është operacioni i vetëm në botë i zhvilluar kundër terrorizmit, pa shkaktoar asnjë viktimë civile. Vendi ynë do të vazhdojë të kryejë atë që është e drejtë, pa bërë lëshime për vijat e kuqe, që janë tërësia territoriale dhe sovraniteti i vendit, do të vazhdojë të përpurojë i vendosur dhe me besim në rrugën e tij të drejtë, duke marrë forcë nga populli ynë. Me këtë rast, në emër të vendit dhe të popullit tim, dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen të gjithë vëllëzërve tanë shqiptarë, të cilët i kanë uruar suksese ushtrisë fitimtare turke në operacionin 'Dega e Ullirit' dhe kanë shprehur ngushëllime për dëshmorët tanë.

ORGANIZATA FETO

"Nuk duhet të harroni se FETO, kur e shikon të arsyeshme dhe sipas udhëzimeve që merr, është një organizatë terroriste që mund të krijojë kaos politik në vendin ku ndodhet dhe të shkatërrtojë rendin kushtetues", thotë ambasadori i Turqisë.

për buxhetin e vëllëzërve tanë shqiptarë. Uroj që si-harëni për këtë ta ndaj në një kohë shumë të afërt me opinionin publik shqiptar.

Z. ambasador, le të flasim për një çështje që konsiderohet mjaft e ndjeshme për Turqinë, operacionin ushtarak në Afrin në veri të Sirisë. Ky operacion po vazhdon prej disa javësh. Çfarë synon të arrijë Turqia në këtë drejtim? Cili është qëllimi?

Para së gjithash, dëshiroj të theksoj se operacioni 'Dega e Ullirit' nuk është një operacion kundër civilëve të pafajshëm ose vëllëzërve tanë kurde. Është një operacion kundër PKK-së, e cila duke u fshehur pas vëllëzërve tanë kurde, por në fakt duke i dhunuar edhe ata, përpiqet për interesat e veta politike dhe ekonomike, si dhe zgjatim it të PKK-së, siç është PYD/YPG. Operacioni 'Dega e Ullirit' synon të pastrojë rajonin nga terrori, të shpëtojë popullsinë e rajonit nga presionet dhe dhuna, t'i sigurojë rajonit qetësi, paqe, siguri dhe stabilitet. PYD/

Autorët i morën xhiron e firmës, një shumë prej 25 mijë eurosh

Grabitja te 'Komuna e Parisit', flet menaxheri: Ja si rashë pre e hajdutëve

TIRANE - Pas grabitjes së ndodhur në zonën e "Komunës së Parisit" në kryeqytet dy ditë më parë, ku menaxherit të një firme private ra pre e dy hajdutëve teksa hynte në një bankë të nivelit të dytë, të tjera detaje dalin në dritë. Mësohet se autorët i kanë grabitur një shumë prej 25 mijë euro menaxherit, i cili merret me industri ushqimore dhe transport internacional. Gjatë dëshmisë së tij në polici, Spahiu tha se dy

DËSHMIA

"Pashë që dy persona po qëndronin pas makinës sime rrugës kur po shkoja në bankë, por nuk e mendova se ata do më grabisnin. Kur parkova makinën te banka te Komuna e Parisit, dola dhe në dorë mbaja qesen me para. Sapo dola nga makina, m'u afrua njëri nga grabitësit, më qëlloi me shpullë dhe në dorë mbante një shufër hekuri. Më mori qesen duke më kërcënuar dhe u larguan me motor", - ka thënë në dëshminë e tij Adem Spahiu.

grabitësit me motor e kanë ndjekur atë përgjatë rrugës që ka bërë për te banka. Sapo ka parkuar pranë bankës për

të depozituar 25 mijë euro që ishin xhironja e firmës, njëri prej personave që ndodhej në motor e ka goditur me



Vendi ku ndodhi grabitja

shpullë dhe ja ka marrë me forcë qesen me para. Po ashtu 40-vjeçari tha se nuk kishte arritur të shquante fytyrat e personave që e grabitën, pasi ata kishin vendosur skafandër dhe doreza. "Pashë që dy persona po qëndronin pas makinës time rrugës kur po shkoja në

bankë, por nuk e mendova se ata do më grabisnin. Kur parkova makinën te banka te Komuna e Parisit dola dhe në dorë mbaja qesen me para. Sapo dola nga makina mu afrua njëri nga grabitësit, më qëlloi me shpullë dhe në dorë mbante një shufër hekuri. Më mori qesen duke më kërcënuar dhe u larguan me motor", - ka thënë në dëshminë e tij Adem Spahiu. Ndërkohë grupi hetimor ngre dyshime se dy personat me motor kanë patur dijeni për paratë që po transportoheshin. Sakaq policia po punon për sekuestrimin e pamjeve filmike të zonës përreth. Gjithashtu, grupi po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve.

Gjykata e Tiranës shpall të pafajshëm dy ish-zyrtarët e Doganave

Mashtrimi me karburantet, dënohet me 10 vite burg Ardian Xhillari

Shiti në tregun vendës 4.4 mln litra naftë 'virgin'

Biznesmeni Ardian Xhillari, i akuzuar për skandalin me naftën 'Virgin' është dënuar ditën e djeshme nga Gjykata e Tiranës me 10 vite heqje lirie. Vendimi për masën e sigurisë "arrest me burg" ndaj Xhillarit u dha në mungesë, pasi biznesmeni ndodhet nën arrest në Gjermani. Pas hetimit të prokurorisë, Xhillari u shpall dy vite më parë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet shqiptare, por vetëm në datën 1 shkurt u bë i mundur ndalimi i tij në Gjermani. Ndërkohë dy të pandehurit e tjerë në proces, ish-zv/drejtoresha e Doganave, Lula Njebza dhe ish-kryetarin e Doganës Tiranë, Mirarbër Teneqexhiu, të akuzuar për "shpërdorim të detyrës" fituan pafajësi.

NGJARJA

Gjykata e Tiranës vendosi të enjten dënimin e Xhillarit me 15 vite burg, nga të cilat do të vuajë vetëm 10 vite për shkak të gjykimitt të shkurtuar. Konkretisht gjykata vendosi deklarimin fajtor për biznesmenin për kryerjen e veprave penale 'Fshehja e të ardhurave', 'Mospagim i taksave dhe tativeve' dhe 'Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale'. Sipas gjykatës, përmes shoqërisë së tij "Tea Construction & Petrol" sh.a., Xhillari ka kryer transportin fiktiv

ARRESTIMI

Vendimi për masën e sigurisë "arrest me burg" ndaj Xhillarit u dha në mungesë, pasi biznesmeni ndodhet nën arrest në Gjermani. Pas hetimit të prokurorisë, Xhillari u shpall dy vite më parë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet shqiptare, por vetëm në datën 1 shkurt u bë i mundur ndalimi i tij në Gjermani.



Ardian Xhillari

të një sasi prej 4.4 milion litra naftë "virgine" nga një magazinë në Kodër Mëzez Tiranë për në magazinën doganore në Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh. Kjo lloj naftë është mbetje teknologjike hidrokarbure, që nuk mund të tregtohet apo të përpuno-

het në territorin shqiptar. Por në këtë rast ka rezultuar se transporti është bërë vetëm në letra dhe sasia e naftës është hedhur në treg. Sipas prokurorisë në 2015-ën Xhillari, si administrator i kompanisë Tea Construction & Petrol SH.A., në bashkëpunim me persona të tjerë

ka kryer transportin fiktiv të 4.4 milionë litrave naftë Virgin. Organi i akuzës kërkoi 15 vite burg për Ardian Xhillarin, dhe 5 vite për ish-nëndrejtoreshën e doganave Lula Njebza. Biznesmeni Xhillari i shpallur në kërkim ndërkombëtar u arrestua në 1 shkurt në Frankfurt të

AKUZA

Përmes shoqërisë së tij "Tea Construction & Petrol" sh.a., Xhillari ka kryer transportin fiktiv të një sasi prej 4.4 milionë litra naftë "virgin" nga një magazinë në Kodër Mëzez, Tiranë për në magazinën doganore në Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh.

Gjermanisë. Policia njoftoi se arrestimi i tij u bë me kërkesë të Interpol Tiranës dhe u krye në bashkëpunim me homologët e tyre gjermane. Pritet të nisin procedurat për ekstradimin e Xhillarit në Tiranë ku edhe do të vuajë dënimin e dhënë nga gjykata penale.

SHKURT

Ministria e Brendshme emëron drejtorin e SHÇBA

TIRANE - Pas akuzave të Partisë Demokratike për komandimin e ish-gjyqtarit Agim Hysi në krye të SHÇBA, Ministria e Brendshme ka emëruar në këtë post Anila Trimin. Ajo është emëruar ditën e djeshme në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA). Ajo zëvendëson në këtë detyrë Eduard Merkajn, i cili u emërua më herët në detyrën e Drejtorit të Departamentit të Policisë Kriminale, në Policinë e Shtetit. Që prej tetorit të vitit 2017, znj.Trimi ka mbajtur postin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme. Më herët, ajo ka drejtuar Drejtorinë e Përgjithshme të Antitrafikut dhe Azilit në MB dhe ka punuar në Policinë e Shtetit në Drejtorinë Kundër Krimitt të Organizuar. Znj.Trimi është diplomuar në Akademinë e Policisë, si dhe për Drejtësi. Në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme është emëruar z.Dritan Palnikaj, i cili ishte pjesë e kabinetit të Kryeministrit, e më herët ka qenë Këshilltar i ministrit të Brendshëm.

Desja e ish-kryebashkiakut të Kavajës, Elvis

Rroshit në gjykatë

TIRANE - Prokuroria e Tiranës ka dërguar në Gjykatë dosjen e ish-kryebashkiakut të Kavajës, Elvis Rroshi. Ish-kryebashkiaku i Kavajës akuzohet për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i vulave, stampave apo formularëve". Në datën 09.06.2016 mbi bazën e akteve të ardhura nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar Procedimi Penal nr.4810 nr.4810, për veprën e mësipërme penale. Por sipas prokurorisë, shtetasit Elvis Rroshi i është vërtetuar e kundërta e përgjigjes mohuese për dënim për vepra të ndryshme nga ndonjë autoritet i huaj. "Subjekti i ligjit në fjalë, ka fshehur përdorimin e disa emrave në të shkuarën e tij të arrestimeve, ndalimeve, dënimeve, dëbimeve, masave të ndryshme sigurie dhe shtrënguese në Itali, Zvicër dhe Gjermani, falsifikim dokumentesh, shqiptare dhe të huaja", -thuhet në njoftim. Gjithashtu, në vitin 2015, DEA/US ka informuar autoritetet zviceriane se ata po hetonin një shtetas të quajtur Enver Rroshi për trafik droge dhe pastrim parash, nuk ka detaje të mëtejshme në lidhje me këtë.

Në kuadër të mbështetjes për policinë shqiptare për monitorimin ajror të territorit dhe për parandalimin dhe goditjen e kultivimit të bimëve narkotike, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardë Veliu, i shoqëruar nga drejtues të lartë të Policisë, priti ditën e djeshme një delegacion të policisë italiane, të përbërë nga Policia Kriminale e Guardia di Finanza, projekti "SANCAS" dhe Qendrës



Nis projekti "SANCAS" për monitorimin ajror të vendit kundër kultivimit

së Ekselencës "BENECON". Drejtori i Përgjithshëm Veliu, shprehu konsideratën dhe falënderimet e tij për projektin "Mbështetje për Strategjinë Antikanabis-Mbikëqyrja Ajrore" si dhe ka theksuar se Policia e Shtetit është e angazhuar që rezultatet e arritura gjatë vitit 2017 kundër fenomenit të kultivimit

Kanabisit jo vetëm të ruhen, por që këtë vit ky fenomen të mos ekzistojë më. Më tej ai bëri prezent komponentët ku do mbështetet projekti, për të operuar më tej në terren: "Në eksperiencën e fituar në kontrollin e territorit dhe luftës ndaj kultivuesve dhe trafikuesve të kanabisit, gjatë vitit 2017; Në një analizë të

plotë për të gjithë periudhën paraardhëse, mënyrat e kultivimit, rrugët e trafikimit të kanabisit dhe duke bashkëpunuar do të arrijmë në hartimin e një strategjie efektive policore, por jo vetëm, si dhe në rritjen e orëve të fluturimeve për këtë vit, ku është llogaritur të jenë 30% më shumë se në vitin 2017"

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" RISITË, PROGRAMET E BURSAT

Shefja e departamentit të Ekonomiksit: Interes i lartë nga studentët dhe gjimnazistët

Voltiza Duro

Pjesë e panairit "Work & Study" 2018 është edhe institucioni elitari i arsimit të lartë në vend, Kolegji Universitar "Luarasi". Gjatë këtyre ditëve, ekspertët e këtij universiteti kanë prezantuar për qindra gjimnazistë e studentë të interesuar, sukseset dhe arritjet e deritanishme, si dhe programet dhe risitë për Fakultetin e Ekonomisë e Drejtësisë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", shefja e departamentit të Ekonomiksit në Kolegjin Universitar "Luarasi", Aelita Mani tregon se vitin e ri akademik do të çelët edhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, duke iu përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, lokal dhe global. Mani më tej shton se bursat studentore patën një vend të dukshëm në stendin e këtij institucioni elitari, duke prezantuar mbështetjen jo vetëm për nxënësit dhe studentët ekselentë, por edhe për shtresat në nevojë. Këtë vit

Çfarë ka prezantuar Kolegji Universitar "Luarasi" në Panairin "Work & Study" 2018?

Kolegji Universitar "Luarasi" në Panairin "Work & Study" 2018 së pari ka prezantuar vizionin dhe vlerat e një institucioni cilësor dhe elitari, që punon për krijimin e elitave të profesionistëve që dalin nga bankat e tij, duke i aftësuar dhe përgatitur për tregun e punës dhe shoqërinë. Në këtë panair u prezantuan sukseset dhe arritjet e deritanishme, si dhe faktet e arritjeve nga studentët tanë, si rezultat i punës së palodhur të brezave që kanë kontribuar në "Luarasi" dhe mbështetjes së vazhdueshme dhe vlerësimit që i ka dhënë këtij institucioni "HYSENBELLIU GRUP". Gjatë ditëve të panairit u prezantuan bursat, programet dhe risitë për të dy fakultetet, të Ekonomisë dhe Drejtësisë, si dhe hapja e fakultetit më të ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, duke iu përshtatur me programet e tij, kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, lokal dhe global, për specialistë dhe teknikienë të aftë dhe konkurrent, që mund të punojnë denjësisht kudo.

Ju thatë që janë prezantuar edhe bursat që jep ky institucion elitari. Cilat janë kriteret për të përfutur bursat?

Bursat studentore janë një vend të dukshëm në stendin tonë, duke prezantuar mbështetjen jo vetëm

"Luarasi", prezantim i suksesshëm në panairin "Work & Study"

Aelita Mani: Punojmë për krijimin e elitave të profesionistëve



Aelita Mani, shefe e departamentit të Ekonomiksit në Kolegjin Universitar "Luarasi"

për nxënësit dhe studentët ekselentë, por edhe për shtresat në nevojë. Këtë vit

"Luarasi" do të ofrojë shumë lloje bursash të bazuara mbi parimin e meritokracisë dhe

motivimit për nxënësit dhe studentët të ekselencës, por edhe për të mbështetur

nxënësit që përzgjedhin "Luarasin", por që mundësia financiare nuk ua lejon. Por jo vetëm kjo, ne ofrojmë bursa edhe për nxënësit dhe studentët që janë aktivistë të shoqërisë apo me arritje të shkëlqyera në sporte, arte dhe kulturë.

Cilat janë disa prej risive që ofron ky universitet?

Në këtë panair "Luarasi" erdhi dhe me shumë risi, duke iu përshtatur nevojave të tregut të punës dhe kohës, siç janë masterat profesionalë dhe kurset profesionale për studentët që ndjekin të dyja nivelet e programeve, bachelor dhe master, por edhe për ata që tashmë e kanë një diplomë dhe duan të plotësojnë njohuritë e tyre me dije dhe njohuritë më të reja.

A pati interes nga ana e gjimnazistëve për stendin e "Luarasit"?

Kolegji Universitar "Luarasi" gjithmonë e më shumë po zgjon interesin jo vetëm të gjimnazistëve si zgjedhje të parë, por edhe të studentëve nga institucionet e tjera akademike. Kjo u duk edhe nga vizitat dhe interesi që treguan pranë stendës sonë. E veçantë këtë radhë ishte se pranë stendës sonë erdhën dhe u interesuan edhe gjimnazistët të viteve të dyta.

Si u shprehën nxënësit dhe studentët e pranishëm gjatë prezantimit?

Ata na konsiderojnë si institucion i vlerave dhe mundësive. Sot nxënësit dhe studentët janë më kërkues, hulumtues dhe me këmbë në tokë kur vjen fjala për të vendosur për të ardhmen e tyre dhe kujt mund t'ia be-

sojnë investimin më të madh për fillimin e një karriere të sukseshme. Ata ishin të interesuar të shihnin nga afër mundësitë dhe programet që ne ofrojmë. Pyetjet e tyre ishin të shumta, pasi na kanë ndjekur me interes gjatë këtyre viteve.

Çfarë do të ofrojë fakulteti i ri i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, që do të çelët në vitin e ri akademik?

Hapja e fakultetit më të ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit është një nga risitë më të fundit, duke iu përshtatur me programet e tij kërkesave dhe nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës, pasi pajisja me njohuritë më të fundit mbi ICT tashmë është bërë jetësore për të gjithë. Gjithçka po shkon drejt globalizimit dhe dixhitalizimit. Ky fakultet do të ofrojë programe në bachelor mbi sigurinë kibernetike dhe informacionit si dhe master profesional dhe shkencor. E veçanta e programeve është se mund të studiojnë edhe studentët me njohuri dhe eksperiencë nga fusha të ndryshme.

Stenda e Kolegjit Universitar "Luarasi" në panairin e punës dhe studentëve u vizitua edhe nga vetë ministria e Arsimit, Lindita Nikolla. Si u shpreh ajo në lidhje me arritjet e "Luarasit"?

Stenda jonë u vizitua edhe nga personalitete të akademisë dhe institucioneve vendore. Në mënyrë të veçantë, ministria e Arsimit dhe Sporteve, znj. Lindita Nikolla, ndaloi dhe përsëriti dhe vlerësoi edhe njëherë punën dhe përpjekjet e Kolegjit Universitar "Luarasi".

bashkëpunimi
german
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

**OPEN CALL FOR TENDER
PREQUALIFICATION**

- 1. GENERAL CONDITIONS**
- 1.1. Requester:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Country Office Albania in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1.
- 1.2. Profile:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is an experienced service provider and assists the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation. GIZ offers demand-driven, tailor-made and effective services for sustainable development
- 1.3. Subject:** The GIZ Office Tirana invites authorized and registered companies to express their interest in providing one off-road vehicle (4X4).
- 1.4. Companies should fulfill the following requirements:**
 - 1) Be an authorized and licensed dealer/partner from the manufacturer. According certificate must be provided.
 - 2) Provide a warranty up to 100.000 km drive for the vehicle.
 - 3) Offer quality service for the vehicle within the warranty duration. All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de
- 1.5. Due date for submitting the application is 11.04.2018. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: "PROVISION OF Off-Road Vehicle (4x4)", addressed to:**

**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,
Rr. Skenderbeg, Nr 21/1
Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Manastirliu: Kërkohen vetëm dy dokumente, u japim fund praktikave abuzive

Lehtësohen procedurat e KMCAP për aftësinë e kufizuar

"Rikomisionim një herë në 3 apo 5 vjet"



Voltiza Duro


Ka filluar zbatimimi i procedurës për lehtësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke shmangur kështu sorollatjen e tyre detyrë të institucioneve. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu pasi ndoqi nga afër procesin e vlerësimit mjekësor të aftësisë për punë (KMCAP) të personave me aftësi të kufizuara në qarkun e Lezhës, bëri me dije se tashmë kësaj kategorie, për të aplikuar dhe komisionuar pranë KMCAP-ve nuk i kërkohen më 8 dokumente, por vetëm 2 të tilla. "Personave me aftësi të



kufizuar, për të aplikuar dhe komisionuar pranë KMCAP-ve nuk ju kërkohen më 8 dokumente, por vetëm 2 dokumente. Por një tjetër arsye pse ndërmorëm këtë reformë ishte eliminimi i praktikave abuzive dhe korruptive që ndodhin në parë", - u shpreh Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo e fundit më tej bëri me dije se Për kategorinë e përfutuesve të

pagesave të aftësisë së kufizuar me diagnoza të përshërshme, që deri dje detyroheshin të rikomisionoheshin çdo vit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vendosur rikomisionimin 3-5 vjet, duke ju kursyer personave me aftësi të kufizuara 16 orë sorollatje për këtë shërbim. "Më vjen mirë të konstatoj se ka filluar të zbatohet procedura e re që kemi

miratuar për të lehtësuar personat me aftësi të kufizuara për përfitimim e pagesës që ju takon pas vlerësimit nga KMCAP. Siç po shohim sot këtu, asnjë person me aftësi të kufizuara nuk paraqitet më pranë ambienteve ku zhvillohen komisionimet nga KMCAP, ndryshe nga sa ndodhte më parë, por vendimi merret nga komisioni bazuar në dokumentacionin e dosjes së paraqitur, ndërsa përgjigja i dërgohet qytetarit në shtëpi nga administratori shoqëror në njësinë vendore ku banon", tha Manastirliu nga Lezha. Sipas saj vetëm me këtë hap të ndërmarrë, janë kursyer rreth 40 orë sorollatje për çdo qytetar që komisionohet dhe minimalisht 47 milionë lekë në total, që shpenzoheshin nga qytetarët, vetëm si kosto transporti.



Karaj e Pinderi, letër kryeministrit Rama

Drejtoresha e "Sami Frashërit" nuk pranon aktivitetin e LGBT-së në shkollë

Aktivitetin e LGBT që prej disa ditësh kanë ndërmarrë një fushatë sensibilizuese nëpër gjimnazet e kryeqytetit, për të diskutuar me adoleshentët e këtyre shkollave mbi bullizmin dhe fenomene të eksperiencave të tyre, kanë ndeshur pengesën e parë. Edhe pse fushata e tyre ka miratimin e qeverisë, drejtoresha e gjimnazit "Sami Frashëri", Teuta Dobi ka vendosur të mos i pranojë në këtë shkollë e të mos i lërë të vijojnë fushatën e tyre. Deklarata e Dobi-t ka ngjallur shqetësimin, prandaj Xheni Karaj, drejtoresha e Aleancës LGBT dhe Kristi Pinderi, anëtar i bordit të drejtorëve të Pro LGBT i janë ankuar publikisht kryeministrit Edi Rama nëpërmjet një letre. "Zoti Rama, Ashtu siç jemi të sigurt se ju e dini shumë mirë, ky është një rast flagrant që nuk duhet lënë pa përgjigje. Zonja në fjalë jo vetëm që ka shkelur gjithë kodet e etikës të profesionit të nderuar që përfaqëson por mohimi për të trajtuar këdo në mënyrë të barabartë është një veprim i dënueshëm nga ligjet shqiptare", thuhet në letrën drejtuar Ramës. Përfaqësuesit e komunitetit LGBT në Shqipëri më tej i kanë bërë me dije kryeministrit se do të njoftojnë çdo organizëm ndërkombëtar brenda dhe jashtë Shqipërisë për këtë rast dhe për dhjetëra raste të tjera flagrante kur mësuesit keqtrajtojnë personat e perceptuar si pjesëtarë të komunitetit LGBT. "Ne tashmë kërkojmë hapa konkretë që të bindemi se e keni seriozisht çështjen e respektimit të të drejtave të njeriut", - mbyllet letra.

KERKESE PER SHPREHJE INTERESI (SHERBIM KONSULENCE – PERZGJEDHJE E KOMPANIVE)

SHOIPERI
PROJEKTI I SIGURISE SE DIGAVE
 Kredia Nr.: 4480 AL

Emertimi: MENAXHIMI FINANCIAR DHE NDTERTIMI I KAPACITETEVE
 Bid Nr.: DSP-IDA-06-18

Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore kundrejt kostonë së Projektit të Sigurisë së Digave dhe ka për qëllim të aplikojë pjesë të shumës për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulcencës ("Shërbimet") përfshijnë asistencën për KESH-in në përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit financiar në mënyrë që të zhvillojë dhe mirëmbajë sistemin e menaxhimit dhe të raportimit financiar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të raportimit. Niveli i vlerësuar i angazhimit të stafit është 6 MM. Detyra pritet të fillojë nga fundi i muajit Maj 2018 dhe të kompletohet në fund të vitit 2019.

Termat e detajuara (ToR) për detyrën në fjalë mund të sigurohen në adresën e mëposhtme.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) fton firmat konsulente të ligjshme që të shprehin interesin e tyre në dhenien e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të japin informacion duke demonstruar që kanë kualifikimet e kërkuara dhe experiencën e duhur për të kryer Shërbimet. Kriteret e përzgjedhjes së short listes janë:

| Nr | Kriteri/Nenkriteri | Piket |
|---------------|---|------------|
| 1 | Eksperiencat e meparshme e firmes Consulente ne shërbimet e kërkuara | 70 |
| a | Eksperiencë në ofrimin e shërbimeve të keshillimit në Procesin e Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar | 25 |
| b | Eksperiencë në vlerësimin e asetëve dhe të testimit të zhvlerësimit në industrinë e prodhimit të energjisë elektrike | 25 |
| c | Eksperiencë në Trainim dhe ndërtimin e kapaciteteve në fushën e kontabilitetit dhe të procesit të raportimit financiar. | 20 |
| 2 | Organizimi i kompanisë dhe punësimi | 10 |
| 3 | Disponueshmëria e stafit të kualifikuar brenda kompanisë | 20 |
| Totali | | 100 |

Ekspertët kryesorë nuk do të vlerësohen në stadin e shortlistimit.

Konsulentët e interesuar duhet të kenë parasysh paragrafin 1. të Udhezuesit të BB: Përzgjedhja dhe punësimi i Konsulenteve (nen Huatë e IBRD dhe Kredite e IDA & Grantet) nga Huamarresit e BB, Janar 2011 dhe Rishikuar Korrik 2014 (Udhezuesi i Konsulencës) që paraqet politikat e Bankes Botërore në konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të shoqërohen me firmat e tjera për të përmirësuar kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse bashkëpunimi i tyre është në formën e një sipërmarrjeje të përbashkët apo të nenkontraktimit. Në rastin e sipërmarrjes së përbashkët, të gjithë partnerët në sipërmarrje duhet të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës gjatë gjithë kontratës, nese do të përzgjidhen.

Konsulentët do të përzgjidhen në përputhje me metodën e bazuar në kualifikimet e konsulentit sic paraqitet në Udhezuesin e Konsulencës.

Informacion me i plotë mund të merret në adresën e mëposhtme gjatë orëve zyrtare **09:00 deri 16:00**.

Shprehjet e Interesit do të dorëzohen në formën e printuar në adresën e mëposhtme si dhe në formë elektronike me e-mail brenda datës **25 Prill 2018**.

PMU/KESH (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare)
 Në vëmendje: Fatos Bundo
 Drejtor i Projektit
 Rruga: Eshref Frashëri, Kompleksi Vizion Plus, Nr.8
 Tirane, Shqipëri
 Tel: +355 4 2262148
 Fax: +355 4 2262148
 E-mail: BundoF@kesh.al

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING SERVICES – FIRMS SELECTION)

ALBANIA
DAM SAFETY PROJECT
 Credit No.: 4480 AL

Assignment Title: FINANCIAL MANAGEMENT AND CAPACITY BUILDING
 Reference No.: DSP-IDA-06-18

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Dam Safety Project, and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The consulting services ("the Services") include assistance to KESH in improvement of its financial management capacity in order to develop and maintaining the financial management system and reporting in full compliance with IFRS standards. The estimated level of effort is 6 professional man months. The assignment is expected to start on end of May 2018 and completed by end of year 2019.

The detailed Terms of Reference (TOR) for the assignment can be obtained at the address given below.

The Albanian Power Corporation (KESH sh.a.) now invites eligible consulting firms ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The shortlisting criteria are:

| Nr | Criteria/Subcriteria | Points |
|--------------|--|------------|
| 1 | Previous experience of the Consulting firm on the services requested | 70 |
| a | Experience in providing advisory services in the area of Accounting and Financial Reporting Process | 25 |
| b | Experience in asset valuation and impairment testing in the power generation industry | 25 |
| c | Experience in Training and Capacity Building in the area of Accounting and Financial Reporting Process | 20 |
| 2 | Company organization and staffing | 10 |
| 3 | Availability of the qualified staff within the firm | 20 |
| Total | | 100 |

Key Experts will not be evaluated at the shortlisting stage.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's *Guidelines: Selection and Employment of Consultants (under IBRD Loans and IDA Credits & Grants) by World Bank Borrowers* January 2011 and Revised July 2014 ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms to enhance their qualifications, but should indicate clearly whether the association is in the form of a joint venture and/or a sub-consultancy. In the case of a joint venture, all the partners in the joint venture shall be jointly and severally liable for the entire contract, if selected.

A Consultant will be selected in accordance with the Consultant Qualification method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours **09:00 to 16:00 hours**.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below and by e-mail by **25 April 2018**.

PMU/KESH (Albanian Power Corporation)
 Attn: Fatos Bundo
 Project Director
 Street: Eshref Frashëri, Kompleksi Vizion Plus, No.8
 Tirana, ALBANIA
 Tel: +355 4 2262148
 Fax: +355 4 2262148
 E-mail: BundoF@kesh.al

KËSHILLI BASHKIAK I TIRANËS VENDIMET

MBLEDHJA/ Miratohet lista e studentëve të arsimit të lartë që përfitojnë bursë

Voltiza Duro

Rreth 500 familje të pas treha në kryeqytet do të kenë mundësi të aplikojnë për kredi të butë për blerjen e një banese, në rastet që plotësojnë kriteret e përcaktuara. Ditën e djeshme, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak të Tiranës ku u vendos që të gjitha familjet që do të shpallen fituese do të kenë mundësi që të përfitojnë subvencionim të interesave të kredisë për blerjen e një shtëpie të re. Kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë mbledhjes theksoi se kjo mënyrë është një zgjidhje efikase për ti dhënë zgjidhje problemit të strehimit në Tiranë. Përfitues potencial në programin "Subvencionimi i interesave të kredisë për familjet e reja", do të jenë familjet e reja që: përbëhen nga çifti i ri me moshë totale deri në 70 vjeç; përbëhen nga familje të reja që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuara apo persona në pension; nuk kanë në pronësi një banesë; kanë të ardhura sipas limitit të përcaktuar në këtë program; si dhe ata që nuk janë dhe nuk kanë qenë përfitues të programeve të tilla të ngjashme më parë. Kështu, Këshilli Bashkiak ka marrë vendimin për të ndryshuar disa nga përbërësit e skemës së subvencionimit të interesave të kredisë dhe kufijtë minimal dhe maksimal të nivelit të të ardhurave që duhet të plotësojnë aplikuesit. "Së pari, ndryshon mosha e përfituesve, pasi është marrë në konsideratë fakti që disa përfitues për shkak të moshës së madhe janë penguar në klafifikimin për kredi. Tashmë mosha e çiftit duhet të jetë me moshë totale deri në 70 vjeç. Së dyti, afati subvencionimit të kredisë do të rritet nga 15 në 20 vjeç, duke bërë që kështu muor për një familje përfituese të jetë më i ulët dhe më i përballueshëm. Së treti, ndryshojnë edhe të ardhurat e përkohshme", nënvizoi Veliaj.

VENDIME TË TJERA
Fëmijët që vuajnë nga sëmundje të rënda, autik apo me sindromën down do të përjashtohen nga tarifa mujore e ushqimit në çerdhe dhe kopshte. "Zerim të detyrimit muor, pra shërbim pa pagesë janë: Fëmijët me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike apo me sëmundje të rënda të trashëguara, siç mund të jenë sëmundje gjaku, sëmundje të brendshme sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor", tha Veliaj gjatë mbledhjes. Gjithashtu, dhe, këshilli bashkiak miratoi edhe listën e studentëve në institucionet e arsimit të lartë publik, që përfitojnë bursë shteti për vitin akademik 2017-2018 dhe të listës

Hapen kreditë e buta për 500 familje të pastreha në kryeqytet

Veliaj: Ja kriteret që duhet të përmbushin aplikantët



JA ZONAT PERIFERIKE KU DO TË SHTRIHEN

Vendimi: Të krijohen 3 lagje të reja në kryeqytet


Kryeqytetit do t'i shtohen edhe 3 lagje të tjera, respektivisht në zonën e Freskut, Tiranës së re në Kashar dhe në zonën e Selitës në Farkë. Ky është një tjetër vendim i marrë ditën e djeshme në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës. "Banorët e lagjeve periferike të Tiranës urbane, i duhet të humbasin një ditë të tërë pune apo të udhëtojnë gjatë për të marrë një shërbim në zyrat e njësive administrative. Ndaj nisur nga kjo situatë problematike dhe shqetësimi i vazhdueshëm i qytetarëve të përcjella edhe në dëgësat publike të zhvilluara gjatë muajit nëntor nga Bashkia e Tiranës, si dhe nga peticionet e disa banorëve të zonave të lartpërmendura, Këshilli Bashkiak miratoi vendimin për krijimin e tri lagjeve të reja në kryeqytet si pjesë e zonës urbane, të cilat do të emërtohen "Lagjia nr. 12", "Lagjia nr. 13" dhe "Lagjia nr. 14".", tha Veliaj në fjalën e tij. Sipas këtij të fundit, ky riorganizim i jep zgjidhje një sërë problematikash që kanë qenë një shqetësim i vazhdueshëm për banorët dhe do të sjellë më shumë investime.



së nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike. Më tej, Këshilli dhe pëlqimin për kalimin në pronësi të sipërfaqes prej 235 m² në favor të Ministrisë së Kulturës, si dhe u miratua marrëveshja për projektin "Zgjerimi i impiantit të përpunimit të ujit të Bovillës dhe ndërtimit të një linje të re furnizimi për pjesën perëndimore të Bashkisë Tiranë". Këshilli Bashkiak miratoi edhe disa vendime të tjera me karakter social, si projektvendimet për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1 mars deri në 31 mars 2018; për

VENDIMET E MIRATUARA NGA KËSHILLI BASHKIAK:

- Propozimi për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1 mars deri në 31 mars 2018.
- Miratimi i pagesës për PAK e invalidët e punës për periudhën 1-31 mars 2018.
- Miratimi i kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, për kategoritë përfituese, gjatë periudhës 1-28 shkurt 2018
- Miratimi i familjeve përfituese dhe fondit nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind me fondet e buxhetit vendor, për periudhën 1-28 shkurt 2018 sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
- Miratimi e listës së studentëve në institucionet e arsimit të lartë publik, që përfitojnë bursë shteti për vitin akademik 2017-2018.
- Trajtimi me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë.
- Miratimi i familjeve përfituese dhe fondit nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind nga fondi i kushtëzuar, për periudhën 1-28 shkurt 2018
- Miratimi i sistemit të fëmijëve Flogerta Gorasi dhe Florinda-Manushi, në institucione të përkujdesjes shoqërore.
- Miratimi i listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2017-2018.
- Miratimi i programit social "Subvencionimi i interesave të kredisë", sipas udhëzimit operacional për zbatimin e tij.
- Miratimi i projektit "Fillo me një ide - fito një intership në Bashkinë Tiranë", hartuar sipas udhëzimit operacional për zbatimin e projektit.
- Krijimi i bordeve mbikëqyrëse në Bashkinë e Tiranës, për mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe funksionimin e institucioneve në varësi të saj.
- Krijimi i tre lagjeve në qytetin e Tiranës.
- Miratimi i projektit: "Bibliotekat e lagjeve, si qendra multifunkionale".
- Vendimi 15, për disa ndryshime në vendimin nr. 48, datë 11.11.2015 të Këshillit Bashkiak, "Për krijimin e Tirana Parking", si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë" dhe në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015 "Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës.
- Emërtimi i rrugës në njësinë administrative nr.8, me emrin "Adriatik Kallulli".
- Anëtarësimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, në organizatën botërore të parqeve urbane.
- Vendorsja e busit të nobelistit të parë për paqen "Henri Durant" pranë zonës së digës së Liqenit Artificial Tiranë, në kuadër të zbatimit të projektit "Rikualifikimi i mollit pranë digës së liqenit të Tiranës", financuar nga Kryqi i Kuq.
- Miratimi i projektit "Fondi i rimbursimit të shpenzimeve për prodhimin e produkteve turistike".
- Miratimi i marrëveshjes "Për mbështetjen e projektit", ndërmjet Bashkisë së Tiranës, UKT sha dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet shoqërisë UKT sha dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin "Zgjerimi i impiantit të përpunimit të ujit të Bovillës dhe ndërtimit të një linje të re furnizimi për pjesën perëndimore të Bashkisë Tiranë".
- Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar.
- Një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.132, datë 21.12.2017, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018".
- Dhënia e pëlqimit për kalimin në pronësi në favor të Ministrisë së Kulturës, të sipërfaqes prej 235 m², pjesë e pasurisë nr. 1/256, me sipërfaqe 1644 (një mijë e gjashtëqind e dyzetkatër) m², me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8150".



Këshilltarët e opozitës braktisin mbledhjen

Pasi votuan disa nga vendimet që lidhen me ndihmat sociale, këshilltarët e opozitës kanë braktisur mbledhjen e këshillit bashkiak. Ata më tej janë larguar pas kërkesës së refuzuar që të lënë sallën e këshilltarëve të PS-së, të cilët janë denoncuar nga këshilltarët e Partisë Demokratike. "Sot në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, nisur nga situata e pa ndodhur më parë, ku 6 mandate pas një procesi gjyqësor janë të plotëfshme, grupi i këshilltarëve të LSI, duke e vlerësuar me seriozitet këtë rast të pa precedent ligjor; kërkoi që: këto 6 mandate të mos jenë të pranishme në mbledhjet e këshillit deri në përfundim të plotë të shkallëve gjyqësore. Kjo për të mos cenuar legjitimitetin e votimeve dhe korumit të vendimeve të Këshillit", theksoi në deklaratën e tij për mediat kryetari grupi të këshilltarëve LSI, Elton Halimi. Grupi i këshilltarëve të LSI-së dhe demokratët kanë vendosur të mos marrë pjesë në votimet e vendimeve të Këshillit, duke përjashtuar vetëm vendimet në interes të qytetarëve dhe studentëve.

SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT NËN DIKTATURE

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

"Shkrimtarët Matuka, Shehu e Gani s'e ngritën dollinë e parë për partinë"


Enveri: S'besoj se, dollitë të kenë filluar me 'shëndetin' e popullit të Kurveleshit

Dashnor Kaloçi

Shefqet Peçi ish-komandant "legjendar" par tizan me origjinë nga fshati Picar i Tepelenës, ku dhe ka lindur më 1 maj të vitit 1906, pas vitit 1945 e deri në shembjen e regjimit komunist të Enver Hoxhës, mbajti dhe ushtroi një sërë detyrash të larta shtetërore. Nga grada e aspirantit të cilën e kishte fituar që në fillimin e viteve '30-të gjatë periudhës së Monarkisë së Zogut ku ndoqi një kurs specializimi për armën e Artilerisë, falë kontributit të tij gjatë periudhës së Luftës Antifashiste, si komandant i njëjste të mëdha partizane, (më 1944 komandant i Brigadës së II-të dhe zëvendëskomandant i Divizionit I-rë. Komandant i shtabit të forcave partizane që shkuan në Kosovë. Më 1944-1946 anëtar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar. Më 1945-1949 komandant i Korparmatis III-të, Komandant i Divizionit I-rë të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit, etj.), menjëherë pas vitit 1944 iu akordua grada e gjeneralit dhe shërbeu në Ministrinë e Mbrojtjes deri në vitin 1949 kur u emërua në postin e Ministrit të Komunikacioneve, detyrë të cilën e ushtroi deri në vitin 1951 kur u emërua si ministër i Minierave. Ndërsa nga viti 1953 deri në vitin 1966, Shefqet Peçi ka ushtruar detyrën e kryetarit të Komisionit të Planit të Shtetit, (detyrë tepër e rëndësishme të cilën nga 1945-sa deri në vitin 1947 e ushtroi Nako Spiro dhe vite më vonë, Abdyl Këllezi), kurse nga viti 1966 deri në 1971-in, Shefqeti ishte në detyrën e Ministrit pa Portofol. Ndërsa nga viti 1970 deri në 1982-in, ai shërbeu edhe si nënkryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, pasi ishte deputet që nga legjislatura e parë e vitit 1945 e deri në 1991-in, kur u shemb regjimi komunist. Po kështu veç këtyre detyrave shtetërore, nga viti 1950 deri

në 1991-in, Shefqet Peçi ishte dhe anëtar i Komitetit Qendror të PPSH-së.

Por përveç gjithë këtyre detyrave dhe ofiqeve të larta shtetërore dhe partiake, Shefqet Peçi ishte dhe një "poet", apo më saktë e konsideronte veten të tillë dhe, gjithashtu, autor i disa librave me temë nga "Lufta Nacional-Çlirimtare". Shefqeti nuk shkruante vetëm poezi me temë nga lufta, por edhe ato me temë nga politika ku ai "demaskonte" imperializmin amerikan dhe revizionizmin sovjetik. Kështu në një nga poezitë e tij, ai shkruante: "Them ku është para jua / thonë në Washington / Ku Shtëpi e Bardhë, veç katran kullon". Po kështu përveç poezive që Shefqeti shkruante vetë, disa poetë të tjerë i kanë thurur atij këngë, balada dhe poezi për "trimërit" e tij të treguara gjatë periudhës së luftës, të cilët para viteve 90-të ishin botuar edhe në tekstet shkollore të ciklit të shkollës 8-vjeçare. Në një nga ato poezi kushtuar Shefqet Peçit, midis të tjerash poeti.....shkruante: "Si na ganta nuk na ngeci në Kuç e



Enver Hoxha dhe Shefqet Peçi, Tiranë 1980

në Korab / Kur na thërriste në sulm përpara Shefqet Peçi, komandant ynë lab'". Në këtë kontekst, Shefqet Peçi gëzonte dhe një popullaritet të madh në zonën e tij të Kurveleshit ku ishte dhe deputet e ai shkonte herë pas here për të takuar zgjedhësit e tij dhe për të

"zgjdhur problemet e hallet" që ata kishin. Shefqeti kurrë nuk shkante vetëm në zonën e tij elektorale, por ai gjithnjë merrte me vete disa nga miqtë e shokët e tij më të afërt, kryesisht ata që ishin me origjinë nga krahina e Kurveleshit. Dhe më shpesh atë e shoqëronin edhe disa poetë e shkrimtarë me origjinë nga ajo zonë, bashkë si të cilët ai merrte pjesë si në mbledhje, ashtu dhe në dreka e darka që shtrinin për të si "populli" i asaj krahine, ashtu dhe organet e pushtetit lokal, ku rakia shkante lumë me dolli për "Partinë dhe shokun Enver". Lidhur me këtë, bën fjalë dhe dokumenti që po publikojmë në këtë pjesë të librit dhe që mban datën 13.VIII.1973, ku sekretari i Komitetit të Partisë së Tepelenës, Ali Manaj, ka informuar sekretarin e Komitetit Qendror të PPSH-së, Hysni Kapon, me anë të njëjste letrë "personale" me siglën sekret. Ajo çka e ka detyruar sekretarin e Komitetit të Partisë së Tepelenës, t'i shkruante Hysni Kapos, apo më saktë Enver Hoxhës, (pasi ai e dinte fare mirë që letrën e tij, Kapo do t'ia dërgonte menjëherë Enverit), ka qenë

problemi i dollive të rakisë, ku miqtë shkrimtarë nga Tirana që kanë shoqëruar Shefqet Peçin në atë darkë, nuk e kanë ngritur fillimisht për Partinë, por për popullin e Kurveleshit. Sepse sipas "zakoneve të reja" të asaj zone dhe, gjithashtu, gjithë Shqipërisë, dollia e parë ngruhej për "Partinë dhe shokun Enver". Ndërsa në krahinën e Kurveleshit dhe disa të tjera në Jug të vendit, ishte bërë zakon që në dreka dhe darka, ngruhej dolli me gota uji për 13 anëtarët e Byrosë Politike dhe kandidatët e saj. Gjë e cila shpesh herë i vinte në vështirësi miqtë e ftuar që nuk ishin mësuar me ato "zakone", aq sa i bënte ata që jo pak herë të zinin spitalin. Kështu ka ndodhur edhe në darkën ku ka qenë i ftuar Shefqet Peçi me miqtë e tij nga Tirana, gjë e cila është shkruar me detaje nga Ali Manaj. Madje nga njëri prej të ftuarve në atë darkë, mësohet se me nota humorit i është drejtuar Shefqet Peçit, duke i thënë: "Shoku Shefqet, ishalla ky kongres i Partisë që po vjen, do t'i reduktojë pak numrin e kandidatëve të Byrosë Politike, se po na zënë spitalin burrat e fshatit". (Por cuditërisht kjo gjë, nuk është shkruar në raport-informacionin në fjalë). Por problemi kryesor që e ka "shqetësuar" dhe preokupuar "tehtëri" sekretarin e Partisë së Tepelenës, Ali Manaj, nuk ka qenë vetëm sasia e dollive të rakisë që janë ngritur aty, "por dollia e parë" që nuk është ngritur për Partinë, që e thënë më saktë nënkuptonte dollinë për Enver Hoxhën. Dhe po kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore që atë letër, Hysni Kapo ia ka dërguar menjëherë Enver Hoxhës, i cili ka bërë aty edhe një shënim lidhur me atë "ndodhi" ku ka qenë "protagonist" vetë Shefqet Peçi. Edhe pse Enveri nuk ka qenë shumë i rreptë në ato që ka shkruar, nuk dihet me saktësi nëse ka ndikuar kjo letër në dënimin që iu bë po atë vit, poetit Agim Shehu



Shefqet Peçi me Enverin, Nexhmijen dhe Adil Çarçanin, Tiranë

dhe poetit, gazetarit e shkrimtarit ushtarak, Ibrahim Gani, të cilët u përjashtuan nga Partia dhe iu hoq drejta e botimit. (Gjë e cila pasqyrohet edhe në një nga kapitujt paraardhës e këtij libri). Ndoshta qenia e Shefqet Peçit në atë darkë, i ka shpëtuar shkrimtarët që e shoqëronin atë, nga andralla të tjera që mund t'ju vinin edhe nga një dolli rakie e ngritur pa kujdes. Po kështu sipas dokumentit në fjalë (shiko dhe faksimilen përkatëse), edhe Hysni Kapo nga ana e tij ka bërë një shënim ku thuhet: "E thira shokun Bato Karafil dhe e këshillova që të kenë kujdes me trajtimin e çështjeve në bazë të shënimit që ka bërë shoku Enver". Ashtu si dhe pjesa më e madhe e dokumenteve të këtij libri, edhe ku publikohet i plotë.

PARTIA E PUNES E SHQIPERISE Personale
KOMITETI I PARTISE RRETHIT SEKRET
TEPELENE Ekz.

Nr. 1
Nr. 619. Prot. Tepe-
lenë, më 13.8.1973

KOMITETIT QENDRORE TË P.P.S.H.

(Sh. Hysni Kapo)
TIRANE

Ju informojmë se prej datës 6/8/1973 deri më 8/8/1973, zona e Progonatit dhe sektori i Salarisë së kooperativës së bujqësore të bashkuar Dukaj, priten për takime deputetit e zonës së tyre anëtarin e K.Q të PPSH-së dhe N/kryetarin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, shokun Shefqet Peçi. Të cilin e shoqëroja unë, shok



Shefqet Peçi me gradën e gjeneralit në vitin 1949



Fuat Loloçi e Dilaver Pinderi. Gjatë takimit me shokun Shefqet, populli dhe komunistet e kësaj zone shprehën edhe njëherë dashurinë e madhe që ushqejnë për Partinë dhe shokun Enver. Dëgjuan me kujdes porositet që dha shoku Shefqet për detyrat e mëdha që na dalin përpara për të vënë në jetë vendimet e Plenumit të 4-të të K.K. të Partisë dhe mësimet


dritëdhënëse të shokut Enver.
Por neve e shikojmë të nevojshme t'ju informojmë për disa veprime e koncepte që u shfaqën në një darkë të organizuar me këtë rast në kooperativën bujqësore të Progonatit, të cilat na duken se nuk janë të drejta.
Shoku Shefqet gjatë ditëve që ndejti në Progonat kishte marrë me vete për ta shoqëruar edhe disa shokë



Hysni Kapo



Shkrimtari ushtarak, Xhafer Matuka në vitin 1966



Poeti i njohur, Agim Shehu

si p.sh. shokun Xhafer Matuka, oficer, shkrimtar, në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore, shokun Ibrahim Gani, oficer dhe punonjës në redaksinë e gazetës "Luftëtari", shokun Agim Shehu, punonjës në gazetën "Zëri i Popullit", shokun Musa Daci, nga Progonati dhe sot me banim në Tiranë, shokun Maksut Drrasa, mjek kirurg në Spitalin Ushtarak në Tiranë, Faik Dedën nga Nivica, por tani mjek në zonën e Krahësit në Tepelenë.

Gjatë darkës që u organizua me këtë rast në Progonat, siç shpjeguan edhe më lart, kur u ngritën shëndet (doli) me gotën e ujit e cila i detyroi që të dehen shumë shokë nga rakia, kështu p.sh. nga pirja e rakisë në këtë formë, anëtar i Plenumit të Komitetit të Partisë së rrethit dhe kryetari i Këshillit Popullor të Bashkuar Progonat, shoku Gjysh Ruci, humbi ndjenjat dhe si rezultat u hodh nga penxherja e katit të dytë dhe sot ndodhet në spital, por



Ali Manaj, ish-sekretari i Komitetit Partisë Tepelenë

me ndihmën e dhënë, duket se doli jashtë rrezikut.
Gjithashtu gjatë darkës u çfaqën edhe disa koncepte të mëdeshme që Partia vazhdimisht i ka luftuar dhe i Lufton, kështu p.sh. shoku Xhafer Matuka ngriti shëndetin për popullin e Kurveleshit. Kur unë bashkë me shokët e tjerë e shoqëruam këtë shëndet duke shtuar edhe shëndetin e të gjithë

popullit Shqiptar, e të shokut Shefqet Peçi, të Partisë së Punës së Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye, shoku Xhafer Matuka i nisur nga pozita lokaliste, më bëri presion në mënyrë të padrejtë. Ai u shpreh: "Se dollia duhet pirë vetëm për popullin e Kurveleshit".

Unë me gjakftohësi e korrektësi, u përpoqa se ato që thashë ishin të drejta, që shprehin dashurinë për popullin e Kurveleshit dhe popullin Shqiptar, për shokun Shefqet, për Partinë dhe shokun Enver, të cilët na siguruan ditët e bardha që gëzojmë në sot. Por disa nga shokët e ardhur nga Tirana nuk më mbështetën si duhet. Por përkundrazi: shoku Musa Daci, përsëri nga pozitat e lokalizmit, u ngrit menjëherë në mbrojtje të Xhafer Matukës, bile duke kaluar më tej konceptin e tij duke u shprehur: "Dollinë do ta pimë për popullin e Kurveleshit, i cili sot nuk është më i bashkuar, lanet të kenë ata që u bënë sebeb për ta ndarë". Kjo e prishi edhe më keq atmosferën e gëzuar, sepse u përsërit një problem, që nuk ekzistonte në popullin e Kurveleshit, por që e hedhin hera herës, njëherë të veçantë që janë Kurveleshas

dhe banojnë në Tiranë e gjetkë. Ne prisim që këtyre mendimeve të shtrembëra t'ju jepej përgjigje, por asnjëri nuk e bëri.

Në mbledhjen e popullit të Salarisë, (sektori i kooperativës bujqësore Dukaj), kur shoku Shefqet Peçi foli në parim kundër shfaqjeve të huaja, vjedhjeve dhe shpërdorimeve të pasurisë shtetërore e kooperativiste, ne mendojmë se do të ishte më mirë dhe do të ndihmonte më tepër organizatën e Partisë në rreth e sidomos të kooperativës së bashkuar Dukaj, po të ishte konkretizuar kjo me ato shpërdorime dhe vjedhje të mëdha që kanë bërë kuadrot e kësaj kooperative, për të cilat shoku Shefqet, u interesua dhe ja shpjeguan me hollësi përpara se të merre takimet. Këtë e themi në një kohë kur opinionin i përgjithshëm në Parti e në popull aprovon plotësisht qëndrimin e mbajtur nga organet përkatëse ndaj shkaktarëve.

SEKRETARI I KOMITETIT TE PARTISE RRETHIT


(ALI MANAJ)

SHENIMI I ENVER HOXHES NE LETREN E ALI MANAJT

Nuk besoj se, në atë darkë dollitë të kenë filluar me "shëndetin e popullit të Kurveleshit", dhe të ishte injoruar të ngrihej doli, për popullin, për Partinë, etj., sa që duhej të bënte letërën shoku Ali Manaj. Shoku Ali si udhëheqës i vendit ku ishte ai, sa herë të ngrinte dollinë e parë për popullin dhe për Partinë etj. Në goftë se të tilla doli janë ngritur sa herë... (nuk kuptohet shkrimi) ky e pa e shoku Ali, ishte pa vënd, por ishte me vënd ta ngrihej doli për popullin e Kurveleshit, që meriton jo një doli, por njëqind dollira. Enver

SHENIMI I HYSNI KAPO PER BATO KARAFILIN

Thirra shokun Bato Karafilin dhe e këshillova të kenë kujdes me trajtimin e çështjeve në bazë të shënimit që ka bërë shoku Enver: Hysni Kapo 27.9.1973



REPLIKAT

DEBATI MBI KOMUNIZMIN

Xhufi: 'Tepelena' s'ka qenë Aushvic.

Tufa: Enverist i vjetër, ja dëshmitë

Historiani Pëllumb Xhufi ka publikuar në një studion televizive një dokument të CIA-s rreth kampit të Tepelenës dhe gjatë komentit për dokumentin është shprehur se cilësimi i kampit si Aushvici shqiptar, është banal. "Kampit i Tepelenës ishte ndoshta kampi më i mirë. Ai i Maliqit ishte më i tmerrshëm. Askush nuk e thotë pse u ngrit ky kamp. Pas prishjes me Jugosllavinë, ka ndodhur një gjë e madhe pasi Jugosllavia ngriti bazat në Prizren dhe në Ulqin, ku organizoheshin grupet që arratiseshin nga Shqipëria. Armatoseshin, vinin dhe bënin aksione. Në këtë kamp u izoluan familjet kryesisht nga veriu", tha Xhufi. Ai shtoi se, "këta që e kanë promovuar çështjen e këtij kampi, ku është angazhuar edhe Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tepelenës, e kanë quajtur Aushvici shqiptar, kampi i shfarosjes në masë. Po ta dëgjojmë lobet çifute do të tmerrohen, sepse është një banalizim. Unë kam pasur rastin të shoh dokumentet e CIA-s për këtë kamp që ishin informuar nga njerëz nga brenda. Ata thonë që këta janë familjet e njerëzve të arratisur të sponsorizuar nga Jugosllavia", deklaroi Xhufi. I pyetur nëse ka një numër të vdekurish në këtë kamp, historiani i njohur tha se: "Absolutisht jo! Kanë qenë kazemat e ushtrisë deri në fund të viteve 60. Ato i ka ngritur ushtria italiane, ndërtesa solide me tulla".

Të gjitha deklaratat e më sipërme kanë shkaktuar një lum reagimesh gjatë ditës së enjte. Të gjithë përfaqësuesit e shoqatave apo institutëve që merren me të përndjekurit e kanë kundërshtuar Xhufin, madje disa kanë qenë të ashpër deri në fytyrë.

AGRON TUFJA


Agron Tufa, drejtor i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit shkroi në profilin e tij në rrjetin social 'Facebook', se "në një studio enverist, Pëllumb Xhufi, vë në dyshim ekzistencën e kampit shfarosës të Tepelenës. Cinizëm ekstrem, për të cilin vendet më ish-komuniste të Europës sot, të procedojnë për burg. Por këtu jemi në Shqipërinë e rilindur komuniste".

Debati për kampin e punës gjatë regjimit komunist

Dalin fotot e të mbijetuarve në kampin e tmerrit



Ceremonia e rivarimit të dy vajzave të vogla, Prena dhe Dile Gjokola, që humbën jetën në kampin e Tepelenës



Pëllumb Xhufi

regjimet totalitare komuniste.

Në Republikën Çeke: Kodi Penal përmban një veper të veçantë për një person, i cili publikisht mohon, vë në dyshim, miraton ose përpiqet për të justifikuar gjenocidin fashist, komunist apo krime të tjera të nazistëve apo komunistëve kundër njerëzimit.

Në Hungari: mohimi publik dhe kundërfaktual kur krimet naziste, krimet e komunizmit dhe krimet e tjera kundër paqes dhe njerëzimit ose krimet e luftës është një veper penale.

Në Hungari: refuzimin publik, vënia në dyshim ose degradimi i faktit të genocidit dhe krimeve të tjera kundër njerëzimit, të kryera nga regjimet kombëtare socialiste dhe komuniste - është një veper penale.

Në Lituani: lejimi publikisht, mohimi apo vënia në dyshim e krimeve ndërkombehtarë dhe krimeve të kryera nga BRSS (Bashkimi Sovjetik), ose Gjermania naziste kundër Republikës së Lituaniës apo banorëve të saj, është një veper penale".

Tufa bën me dije se ka disa aspekte mbi të cilat po punohet, e që janë: • Edukimi dhe ndërgjegjësimi; • Projektet kërkimore; • Simbolet e totalitarizmit dhe • Kuadri ligjor mbi mohimin e krimeve

Në raport, gjithashtu, citohet: "Më 16 qershor 2009, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme miratoi kon-



Agron Tufa

luzionet, duke deklaruar se: "Për të forcur vetëdijjen Evropiane të krimeve të kryera nga regjimet totalitare, kujtimi i të kaluarës së trazuar të Evropës duhet të ruhet, pasi pajtimi do të jetë i vështirë pa kujtimin".

AUTORITETI DOSJEVE

Veç Tufës, edhe Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka reaguar në mënyrë të tërthortë. Kryetraj e Autoritetit, Gentiana Mara Sulza, ka publikuar një material historik mbi kampin e Tepelenës, përgatitur me 13 mars 2018 nga Qendra e Studimeve Albanologjike.

Çfarë ishte kampi i Tepelenës?

Në maj 1949 filloi të funksionojë kampi i Tepelenës, në të cilin u dërguan të gjithë të internuarit e kampit të Beratit. Arsyja që u zgjodh Tepelena si vend internimi, mendoj se ka të bëjë me disa lehtësi praktike. Tepelena ishte nën juridiksionin e Drejtorisë së Punëve të Brendshme të Beratit dhe aty gjendeshin disa kabina të mbetura nga koha e push-

timit italian, të cilat u përshtatën si vendbanime për të internuarit. Kampi i Tepelenës u drejtua nga dy komandantë: Bektash Pogaçe (1949-1952) dhe Haki Ibrahim (1952-1953), të dy me arsimim të papërfundur. Organizimi i Tepelenës vazhdoi të ishte një vend i rrethuar me tela me gjemba, në të cilin të internuarit kontrolloheshin nga ushtarë të armatosur. Gjatë viteve 1949-1953, në Tepelenë u vendosën rreth 1500 familje: burra, gra, të moshuar dhe fëmijë.

Tepelena nuk ishte i vetmi vend internimi në Shqipëri, as në këtë kohë dhe as gjatë gjithë viteve të regjimit komunist. Shumë krahina të tjera në Shqipëri shërbyen si vende për të internuar njerëz, faji i vetëm i të cilëve ishte se ishin të afërm të individëve që regjimi i konsideronte të rrezikshëm. Por, Tepelena është kampi, i cili mbeti në mendjen e atyre që patën fatkeqësinë për të jetuar në të. Tepelena mbahet mend për kushtet tejet të vështira të jetesës dhe mungesën e theksuar të ushqimit, të mungesës e theksuar të higjienës, për punën tejet të rëndë që burrat, gratë dhe fëmijët mbi moshën 12 vjeç ishin të detyruar të zhvillonin.

Tepelena mbeti në kujtesën e njerëzve, pasi për shkak të këtyre kushteve të vështira, pati raste të shumta vdekjesh, sidomos në moshë të reja. Ndonëse dokumentet janë të pakta, ato tregojnë që gjatë viteve 1949-1950, lajmërohet për raste vdekjesh nga dizenteria. Ndërkohë që nga muaji tetor 1950 deri në dhjetor të po atij viti numri i fëmijëve është zvogëluar me 285 vetë, fenomen, i cili nuk haset në kampet të tjera të ngjashme.

Disa studues mendojnë se ishte pikërisht vdekshmëria e lartë e fëmijëve në kampin e Tepelenës dhe nevoja për të konsoliduar sistemin e internim-dëbimeve, që i detyroi drejtuesit e lartë komunistë të merrnin vendimin në fund të viti 1953 për ta mbyllur kampin e Tepelenës dhe në përgjithësi kampet e rrethuara me tela me gjemba.

Brezi më i ri i shqiptarëve

ka pak njohuri për çfarë kanë ndodhur gjatë regjimit komunist dhe mekanizmat e përdorura prej tij për të mohuar të drejtat më elementare njerëzore për kundërshtarët realë apo imagjinarë. Dokumentet arkivore për vitet e para të regjimit mungojnë, apo janë shumë të pakta. Kjo për shkak të nivelit shumë të ulët të edukimit të nëpunësve të administratës së asaj kohe. Në kushtet kur po humbasin, për shkak të moshës, edhe dëshmitë e personave që e kanë jetuar atë kohë, shumë shpejt nuk do të kemi mundësi të gjejmë të dhëna mbi këto aspekte të Shqipërisë komuniste.

Në mënyrë që e kaluara të mos harrohet dhe të shërbejë për të kuptuar të tashmen dhe për të ndërtuar në baza më solide të ardhmen, shqiptarët kanë nevojë për të pasur disa vende të kujtesës, si: institucione burgimesh, internimesh etj. Sa i takon sistemit të internim-dëbimeve, kampi i Tepelenës do të ishte ideal si vend kujtese për disa arsye:

1. Ky kamp mbart qindra histori të dhimbshme njerëzore. Për shkak të situatës ekstreme të jetës në Kampin e Tepelenës, ai është përmendur në mënyrë të posaçme nga qeveria amerikane në vitin 1955, si pjesë e ankesës së saj në Kombet e Bashkuara për shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për përdorimin e punës së detyruar si ndëshkim.

2. Ai pasqyron më së miri tipologjinë e kampeve të rrethuara me tela me gjemba, të cilat nuk kanë qenë fenomen i përhapur në Lindjen Komuniste dhe mund të krahasohen vetëm me gullagët sovjetikë.

3. Ndërsa për kampe të tjera të tilla, si ai i Beratit, Krutës, Valiasit, Cërrikut, Shijakut, Porto - Palermos, Kuçovës, Kuçit të Vlorës etj., nuk na kanë mbetur objekte kujtese, për kampin e Tepelenës këto ekzistojnë. Disa nga barakat e kampit të Tepelenës ruhen ende. Për më tepër, skicat e Lekë Previzit na japin dëshmi për t'i rindërtuar kabinetin ku strehoheshin të internuarit.

Përgatitur nga Qendra e Studimeve Albanologjike, datë 13 mars 2018, për të paraprirë punën projektuese të memorialit të Tepelenës.

FILMI


“Bëjmë poezi ngushëllimi me porosi që të mbijetojmë”

Fatmira Nikolli

Si të mbijetosh në një botë ku të jesh artist është luks? Si të mbijetosh në një vend kur arti shitet për tre grosh?

“Bëjmë poezi me porosi”, ngjan si lajmërimet “pranojmë porosi për torta a kostume” a “qepim me porosi”, por duket se nuk ka kurrfarë difference as me të shkruarin, në një kohë kur sekush kërkon që të shkruhet për të, sipas midesë së porositësit. Nga strukturat e propagandës te qokat mediokre, shpesh duket se jetojmë mes një mashtrimi të madh, ku të gjithë bëjmë sikur, pa e kuptuar se cila është fytyra e cili është mendimi; pas maskash e qëndrimesh që nuk dihet të kujt janë dhe në mullinë e kujt e çojnë ujën.

Ndonëse ideja e skenaristit Ylljet Aliçka ka qenë mbijetesa e artistit në një kohë kur arti nuk paguhet e nuk cmohet, duket se të jetuarit me “art të porositur” përfshin një horizont më të gjerë se poezitë e ngushëllimit a skulpturat e vdekjes. A nuk bëjmë të gjithë punë me porosi? A nuk ndryshojmë veçse nga porositësi? A është vallë e mundur të ruash ‘nderin e dinjitetin’ në paç fatin të kesh gjetur porositës të mirë-përndryshe ke humbur gjithçka? A është



Poster i filmit

të e mundur të bësh art, të përcjellësh ide, të ngresh çështje, të bësh debate konstruktive, në një shoqëri ku zor se e gjen ku fshihet lepuri?

Vështirë t’ia dalësh ndryshe: këngëtarët mbijetojnë me dasmat e tallavatë, skulptorët e piktorët me portrete të atyre që nuk janë kërkuar prej atyre që kanë mundësi të paguajnë; ‘poetët’ me tekst kur arti s’vlen një grosh? Analiza, opinione, argumente e shkrime me porosi, i bëjmë të gjitha, pa mundur të kuptojmë se ku fillon mendimi e ku mbaron porosia.

Shfaqet filmi “Poeti” i Ylljet Aliçkës, një ironi me artin ditëve tona



Ylljet Aliçka

FILMI

Filmi me metrazh të shkurtër “Poeti” ka për subjekt fatin e një poeti të talentuar, i cili, përballë vështirësive ekonomike në kushtet e reja të ekonomisë së tregut ka gjetur si mënyrë mbijetese të shkruajë poezi ngushëllimi dhe lajmërimet poetike vdekjesh.

Filmi merret me peripetitë dhe aventurat e poetit në gjetjen e klientelës, pra rasteve të vdekjes. Në ballafaqimin me sfidat që i ofron ky realitet i ri ai pronon histori suksesi dhe his-

tori dështimesh. Për të qenë më i suksesshëm me punën e re, poetit, i duhet të përfitojë nga përvoja popullore e këngëve të vdekjes e të konsultohet me poezitë e shkruara në pllakat e gurët e varreve.

Gjithçka nis me takimin e poetit të njohur Benjamin N me botuesen e tij për të verifikuar nëse ka ndonjë shitje nga libri i tij i fundit. Pasi dëshmohet gjendja e vështirë financiare, poeti i pafat këshillohet të shkruajë më porosi.

Është botuesja që ia propozon punën e re, e pas zhgënjimit fillestar, poeti i dorëzohet fatit të tij. Ai zbulon më tej, se ka edhe të tjerë si veten. Mëson se nëse ai shkruan poezi ngushëllimi e shënime për pllaka varresh, ka skulptorë që tanimë i kanë kushtuar gjithë krijimtarinë skulpturave të varreve. Prej tyre, mëson se klientela sigurohet përmes zyrrave të funeralëve, pavionëve të spitaleve.

Filmi “Poeti”, mbështetur në tregimin “Historia e një poeti” të autorit Ylljet Aliçka, në një plan më të gjerë synon që nëpërmjet përvojës së poetit të diagnostikohet tipologjia e urban-

izmit frenetik modern, në një kohë shndërrimesh vlerash shpirtërore dhe orientimesh të reja morale, të një shoqërie ku gjithçka i nënshtrohet ligjeve të ftohta të tregut, përfshi dhe krijimtarinë artistike.

Dialogët e kursyer, gati-gati një film i heshtur, montazhi i lehtë dhe linear mundëson daljen në sipërfaqe të zhgënjimeve të brendshme të heshtura të poetit, duke vënë theksin në gjendjen e tij emocionale.

Nën një ndriçim të ftohtë, ku sundon grija, përcillet zhgënjimi i një gjenerate.

Dialogët e kursyer, gati-gati një film i heshtur, montazhi i lehtë dhe linear mundëson daljen në sipërfaqe të zhgënjimeve të brendshme të heshtura të poetit, duke vënë theksin në gjendjen e tij emocionale.

Nën një ndriçim të ftohtë, ku sundon grija, përcillet zhgënjimi i një gjenerate.

Nën një ndriçim të ftohtë, ku sundon grija, përcillet zhgënjimi i një gjenerate.

GERMIMET ARKEOLOGJIKE

Zbulohen projektet e reja kërkimore në fushën e arkeologjisë

Një sërë projektesh shkencore të miratuara së fundmi nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, synojnë që përgjatë këtij viti në zgjerimin e gërmimeve arkeologjike, përmes të cilave do të përfitohet informacion i ri mbi qytetet antike dhe sitet arkeologjike të vendit tonë, duke rritur mundësinë për vizitueshmërinë e tyre përgjatë sezonit turistik.

Këtë listë projektesh të reja e ka publikuar në “Facebook”-un e saj ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, e cila pasi radhit projektet shkruan se “këto projekte kërkimore në fushën e Arkeologjisë janë me interes jo vetëm për studiuesit e Institutit të Studimeve Arkeologjike, por edhe për zhvillimin e turizmit kulturor”, një ndër prioritetet e Ministrisë së Kulturës.

Këto do të jenë disa nga stacionet kërkimore dhe kulturore të stinës së diellit që po afrojnë, përfundon Kumbaro.

Projektet:

- qyteti antiko-mesjetar i Kaninës,
- vijimi i gërmimeve në Antigone,
- kërkime në ishullin e Maligradit në Prespë
- varri monumental në qytetin antik të Klosit

- gërmime arkeologjike në kastrumin e Paleokastrës në Gjirokastrë
 - gërmime në Finiq dhe në Butrint
 - ndërtimi i hartës nënujore të Bregdetit,
 - sondazhet arkeologjike në zonën e Nivicës
 - rikthimi në format 3D i Bylisit,
 - gërmimet në fortifikimet prehistorike të luginës së Shkumbinit dhe në vendbanimet prehistorike në Skrapar
 - gërmimet rreth kishës paleokristiane në Hot të Malësisë së Madhe
 - studimi i qytetit ilir të Zgërdheshit
 - projekti i Durrësit mesjetar, fortifikimet e Dukajve në luginën e Vjosës,
 - por edhe rizbulimi pafund i Amantias,
 - i kalasë së Drishtit,
 - i gërmimeve në kalanë e Shkodrës,
 - vijimi i gërmimeve në Oriq
- Në këtë listë vlen të përmenden disa prej projekteve të reja, si p.sh.: “Ekspeditë përnjohëse në qytetin antiko - mesjetar të Kaninës dhe në zonën e Vjosës”, “Paleokastra”, “Kalaja e Pecës në Kukës” “Gërmime arkeologjike dhe valorizim turistik i kishës paleokristiane në fshatin Hot (Malësi e Madhe)”, etj., të cilat për qëllime shkencore e studimore, synojnë kthimin në destinacione turistike të disa prej monumenteve, kështjellave dhe siteve arkeologjike të vendit tonë.



The European Union Delegation to Albania is looking for

Press and Information Officer

Functions include managing outreach activities; follow political developments; managing the EU Delegation website and social media platforms; liaise with EU desks in municipalities.

We offer

- Multicultural working environment
- Competitive salary
- Benefits by law

For complete information and application, please refer to:

https://eas.europa.eu/delegations/albania_en

"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

Deadline for applications: 15/04/2018



Punishtja e ushqimeve në Shkodër

Skandali, për prodhimin e produkteve përdorej vaj makinash. Në kërkim një inxhinier

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një ditë pas bllokimit të një punishte kon-servimi që prodhonte produkte të rrezikshme për popullatën, policia e Shkodrës ka arrestuar tre persona si dhe ka shpallur në kërkim një tjetër. Bëhet fjalë për pronarin e punishtes Gëzim Bala, 60 vjeç, banues në banues në lagjen "Ahmet Haxhia", djalin e tij 26-vjeçar Elis Bala i punësuar në këtë punishte dhe Hydajete Elbasani, 60 vjeçe, me detyrë merceologe. Ndërkaq, është shpallur në kërkim inxhinieri merceolog D.H., 45 vjeç, banues në Tiranë. Në vijim të operacionit janë vënë në pranga një punonjësi i Autoritetit të Kontrollit Ushqimor në Shkodër dhe një ish-punonjësi i këtij autoriteti janë ndaluar nga policia për shpërdorim detyre. Ata janë: Adnan Gradeci, 51 vjeç, me detyrë inspektor pranë AKU-së Dega Shkodër dhe Abdyl Bajraktari, 53 vjeç, me detyrë ish-inspektor, po në AKU. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Gradeci dhe Bajraktari janë ndaluar, pasi kanë mbajtur procesverbale të rreme mbi kushtet e ambientit ku prodhoheshin produktet ushqimore. Prej vitesh punishtja që ndodhet ngjitur me Drejtorinë e Patentave në Shkodër (te lagjia "Skënderbeg") ushtronte aktivitetin e saj. Sipas burimeve policore, në këtë punishte bëhej konservimi i produkteve të ndryshme ushqimore si: reçel, gjalpë, vaj, mjalhtë, specia apo turshi dhe shumë të tjera. Po të njëjtat burime bënë me dije se në kuadër të këtij operacioni u bë sekuestrimi i të gjitha produkteve në cilësinë e provës materiale. Ndërkaq, materialet në ngarkim të personave të mësipërm iu referuan për hetime të mëtejshme prokurorisë së Shkodrës për veprat penale: "Prodhim i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore" dhe "Fshehja e të ardhurave".

PUNISHTJA
Një person, i cili ka parë se si funksiononte kjo punishte ka denoncuar tek portali i qeverisë duke zbuluar kështu skemën abuzive. Menjëherë një grup kontrolli i përbërë nga Hetimi Tatimor, AKU, prokuroria dhe policia

Ushqime në kavanozët e kazanëve të plehrave, arrestohet pronari i punishtes

Në pranga dhe djali i tij e merceologia, ndalohen edhe 2 inspektorë të AKU-së



RREZIKSHMËRIA

Me qindra kavanozë të boshatisur ishin marrë nga kazanët e mbeturinave dhe në to futeshin produktet ushqimore të konservuara për t'u bërë më pas gati për treg. Kavanozët vetëm laheshin dhe nuk përpunoheshin në autoklava, ashtu siç duhet të ndodhte normalisht. Po ashtu, për prodhimin e produkteve përdorej vaj makinash, ndërsa mungonin edhe një pjesë e makinerive që nevojiten, duke mos pasur asnjë lloj sigurie, madje duke qenë të rrezikshme për popullatën në rast të konsumimit të tyre.

kanë mbërritur tek punishtja në fjalë. Sapo janë futur brenda, ata janë shokuar nga çfarë kanë parë me sy. Me qindra kavanozë të boshatisur ishin marrë nga kazanët e mbeturinave dhe në to futeshin produktet ushqimore të konservuara për t'u bërë më pas gati për treg. Kavanozët vetëm laheshin dhe nuk përpunoheshin në autoklava, ashtu siç duhet të ndodhte normalisht. Po ashtu, për prodhimin e produkteve përdorej vaj makinash, ndërsa mungonin edhe një pjesë e makinerive që nevojiten, duke mos pasur asnjë lloj sigurie, madje duke qenë të rrezikshme për popullatën në rast të konsumimit të tyre. Këto produkte



ka edhe një dyqan të vetin në Shkodër, në të cilin tregtojnë këto produkte. Brenda kësaj punishteje nuk respektohej asnjë prej kushteve të sigurisë ushqimore. Hetimi Tatimor dhe inspektorët e AKU-së kanë konstatuar se bëhej fjalë për një rrezikshmëri të lartë të jetës njerëzore, në rast se ndokush do konsumonte ato produkte të konservuara. Ky është rasti i dytë që një subjekt i përmasave të tilla goditet pas atij të pijeve joalkoolike dhe alkoolike në hyrje të qytetit të Shkodrës.

TË ARRESTUAR

1. Gëzim Bala, 60 vjeç, pronari i punishtes.
2. Elis Bala, 26-vjeç, i punësuar në punishte. Hydajete Elbasani, 60 vjeçe, merceologe në punishte.

TË NDALUAR

1. Adnan Gradeci, 51 vjeç, me detyrë inspektor pranë AKU-së.
2. Abdyl Bajraktari, 53 vjeç, me detyrë ish-inspektor, po në AKU.

NË KËRKIM

1. D.H., inxhinier merceolog, 45 vjeç, banues në Tiranë.

Sherr mes dy vëllezërve për motive pronësie, policia parandalon konfliktin

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka parandaluar përshkallëzimin e një konflikti mes dy vëllezërve në fshatin Nënshat të Vaut të Dejës, ndërsa ka arrestuar autorin e ngjarjes. Bëhet fjalë për 60-vjeçarin Luigj Preçi, të cilit gjatë kontrollit në banesë i është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një kallashnikov pa leje. Sipas bluve, ai ishte duke u konfliktuar me

vëllain e tij, H. Preçi për motive pronësie. Ndërhyrja në kohë e uniformave blu parandaloi përshkallëzimin e konfliktit, deri në përdorimin e armës së zjarrit. Materialet procedurale në ngarkim të Luigj Preçit u referuan për hetime të mëtejshme në prokurorinë e Shkodrës për veprat penale "Armëmbajtje pa leje" dhe "Kanosje". Ndërkaq, pritet që gjykata të vendosë masën e sigurisë ndaj tij.

SHKURT

Grabit filialin e bankës, bie në pranga 32-vjeçari

ELBASAN - Një 32-vjeçar nga Librazhdi ka përfunduar në pranga, pasi ka grabitur filialin e një banke të nivelit të dytë në këtë qytet. Burime nga policia lokale bënë me dije se ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Mësohet se rreth orës 01:20 ka rënë alarmi i një banke. Menjëherë policia ka shkuar në vendngjarje dhe pas një pune intensive dhe të mirorganizuar kanë bërë identifikimin dhe arrestimin e autorit të dyshuar Nuredin Sula, i cili kishte marrë disa lekë të holla që kishin qenë mbi banak dhe dosje. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se 32-vjeçari dyshohet të jetë autor edhe i ngjarjes së ndodhur më datë 09.03.2018, ku ka thyer me sende të forta (gurë) xhamin e derës kryesore të po këtij filiali banke në Librazhd. Materialet do t'i kalojnë prokurorisë së Elbasanit për veprime të mëtejshme.

Sekuestrohen 188 kg drogë, kapet 42-vjeçari

FUSHË KRUIJË - Policia e Fushë-Krujës ka arrestuar një 42-vjeçar, pasi iu gjet një sasi lëndësh narkotike. Burime zyrtare nga drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës bënë me dije se, "më datë 28.03.2018 u arrestua në flagrancë shtetasi Artan Kraja 42 vjeç, banues në Fushë-Krujë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në një karrocieri-trailer të prishur që shtetasi i mësipërm e kishte përshtatur si magazinë u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 188 kg e 650 gr lëndë narkotike e dyshuar e llojit marijuanë. materialet në ngarkim të Krajës i janë përcjellë për hetime të mëtejshme prokurorisë për veprat penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike".

Ngriti dronin në Beograd, avokati kroat e ekstradon në shtetin fqinj

Ballist Morina i shpëton burgut serb, transferohet në Itali

Flet vëllai: Ç'më tha në telefon 4 ditë më parë

Ismail Morina, i njohur ndryshe si Ballisti, është ekstraduar para dy ditësh nën masa të rrepta sigurie drejt një burgu në Itali. Prej disa muajsh Ballisti qëndronte i burgosur në Kroaci dhe kërkohej nga Serbia që të ekstradohej atje për të kryer dënimin, pasi sipas tyre, personi që ngriti dronin me flamurin e Shqipërisë së Madhe në Beograd ka nxitur urrejtje mes popujve. Edhe pse jo zyrtarisht, kjo me sa duket është zgjidhja që avokati i tij kroat ka mundur të gjejë, duke hedhur poshtë kërkesën për azil në Kroaci, që ishte opsioni i parë për të shpëtuar nga ekstradimi në Serbi, raporton gazetarja Klodiana Lala për "Balkanweb". Kjo mendohet se do t'i krijojë lehtësi Ballistit për të vazhduar gjykimin, i cili në fund pretendon se do ta shpallë të lirë. Kujtojmë se Ismail Morina prej disa vitesh është rezident në bashku me familjen e tij në Itali. Edhe bashkeshortja e Ballistit është italiane. Xhevhahir Morina, vëllai i Ballist Morinës ka hapur menjëherë televizorin për t'u siguruar nëse lajmi i ekstradimit të vëllait të tij drejt Italisë ishte i vërtetë. I kontaktuar nga gazetarja e "News 24", Klodiana Lala, Morina është surprizuar dhe e ka cilësuar si lajmin më të mirë që ka marrë ndonjëherë, atë që i vëllai nuk do të ekstradohej nga Kroacia në Serbi. "Po të jetë i vërtetë, ku ka lajm më të mirë, gëzoj si vëllai për vëllain. Ishim në depresion prej kaq muajsh, ky patjetër është lajmi më i mirë. Unë kam folur katër ditë më parë me Ballistin, por nuk di asgjë për këtë vendim. Nuk kam biseduar më, nuk më ka treguar asgjë", - thotë ai me zërin që i dridhet nga gëzimi dhe emocionet. "Balkanweb" mësoi se Ismaili është ekstraduar ditën e djeshme nën masa të rrepta sigurie drejt një burgu në Itali, ndonëse Serbia priste të vuante atje dënimin, pasi sipas tyre, personi që ngriti dronin me flamurin e Shqipërisë së Madhe në Beograd ka nxitur urrejtje mes popujve. Ekstradimi drejt Italisë mendohet se do t'i krijojë lehtësi Ballistit për të vazhduar gjykimin, i cili në fund pretendon se do ta shpallë të lirë. Ai qëndroi në burgun e Zagrebit prej datës 10 qershor të vitit 2017, kur policia kroate në



Ismail Morina

fillim zbatoi një kërkesë të shtetit serb, i cili kishte nxjerrë një urdhër arresti ndërkombëtar për ndalimin e Ballist Morinës, por pas disa seancash gjyqësore, drejtësia kroate rezis-

toi, duke mos plotësuar kërkesën e drejtësisë serbe për gjykimin e Ismail Morinës në Beograd. Me transferimin e tij në Itali, duket se edhe lirimi përfundimtar për të është

shumë pranë. Ismail Morina, i ashtuquajtur Ballisti i dronit të Beogradit mbremjen e 14 tetorit të vitit 2014, duket se ka gjetur mënyrën për të shpëtuar nga ekstradimi në Beo-

grad, ku akuzohet për nxitje urrejtjeje mes popujve. Në qershor, Morina u arrestua në Dubrovnik dhe Gjykata kroate vendosi fillimisht ekstradimin e tij në Serbi.

XHEVAHIR MORINA

"Po të jetë i vërtetë, ku ka lajm më të mirë, gëzoj si vëllai për vëllain. Ishim në depresion prej kaq muajsh, ky patjetër është lajmi më i mirë. Unë kam folur katër ditë më parë me Ballistin, por nuk di asgjë për këtë vendim. Nuk kam biseduar më, nuk më ka treguar asgjë", - thotë vëllai i Ballist Morinës.



Përdhunoj 82-vjeçaren, i riu me HIV dënohet me 6 vjet burg në Gjermani

Gjykata gjermane ka dënuar me 6 vite burg një 29-vjeçar nga Maqedonia, i cili përdhunoj një 82-vjeçare. Ngjarja e rëndë u regjistrua në muajin korrik të vitit të kaluar. Maqedonasi i infektuar me virusin HIV, Dzengis D., ka dhunuar disa herë seksualisht shtetasen gjermane, shkruan "Bild". Gjykata vërtetoi fajësinë e tij, pas shumë indicieve, mes tyre kontrollit celular dhe bastisjes në shtëpinë e 82-vjeçares. E moshuara pësoi lëndime, ndërsa duhet t'i nënshtrohet testeve të HIV. 29-vjeçari kishte ardhur në Gjermani në 1992.

Ambasada amerikane paralajmëron rrezik nga sulmet terroriste në Kosovë

SHBA këshillojnë qytetaret e saj në Kosovë që të tregohen të kujdesshëm, duke marrë shkas nga ngjarjet e ndodhura ditë e fundit. Ambasada amerikane ka paralajmëruar rreziqe nga sulmet terroriste në Kosovë. "Mbajeni në dijeni të profilit tuaj në publik dhe mos e tërheq vëmendjen të vetja si amerikane. Shqyrtoni planet tuaja personale të sigurisë: Kriminelët dhe terroristët mund të monitorojnë lëvizjet tuaja. Ndërhyroni rrugën dhe kohën e lëvizjeve tuaja për t'u bërë një objektiv më i paparashikueshëm. Jini të vetëdijshëm për mjedisin tuaj: Identifikoni vendndodhjen e daljeve emergjente dhe të shërbimeve të sigurisë kur ndodheni në vende publike. Shmangni turmat /demonstrimet: Nëse jeni në një zonë ku grumbullohet një turmë (festim, demonstrim, etj.), Përpiguni të largoheni nga zona ose, për të paktën, të shkoni në buzë të turmës ku mund të largoheni nëse është e nevojshme. Qëndroni të vëmendshëm në vende të frekuentuara nga turistët. Monitoroni mediat lokale për përditësimet. Monitoroni mediat sociale, njoftime televizive dhe radio, ose udhëzime nga Ambasada ose Konsullata e SHBA-ve më e afërta", thuhet në njoftimin e ambasadës.

Putin dënon arrestimin e Gjuriçit nga policia e Kosovës

Presidenti serb, Vuçiç këshillohet me presidentin rus për zhvillimet në Kosovë



Aleksander Vuçiç

KOMUNIKATA

Në komunikatë thuhet se Vuçiç kërkoi këshillat e Putinit, "sepse është e qartë që shqiptarët e Kosovës gëzojnë një mbështetje të gjerë të një numri vendesh perëndimore për shpalljen e njëanshme të pavarësisë", dhjetë vjet më parë. Në komunikatë nuk thuhet nëse presidenti rus i ka ofruar ndonjë këshillë. Kremlini tha ndërkaq se presidenti Vladimir Putin e ka dënuar fuqishëm arrestimin e zyrtarit serb. Në një komunikatë u tha se presidenti Putin dhe presidenti Vuçiç diskutuan çështjen e Kosovës "në kontekstin e ak-

sionit provokues të Prishtinës" kundër Marko Gjuriçit, shef i zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë. Në komunikatë thuhet se Putini "e dënoi me vendosmëri" arrestimin e

Gjuriçit, veprim që sipas tij "shkel rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së". Gjuriçit, veprim që sipas tij "shkel rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së". Policia e Kosovës ndërhyri të hënën duke arrestuar zyrtarin e qeverisë serbe, Marko Gjuriç, të cil-

in e dëboi më pas për në Serbi. Ndërhyrja nxiti reagimin e ashpër të Beogradit, por edhe shqetësimet për qëndrueshmërinë e rajonit. Serbia vazhdon të kundërshtojë ashpër pavarësinë e Kosovës, që u shpall në shkurt të vitit 2008 me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe vendet kryesore të Bashkimit Evropian. Rusia, e cila ka shtuar përpjekjet për të zgjeruar ndikimin e saj në Ballkan, vazhdon të mbështesë Serbinë, e cila po ecën nëpër vijën e ngushtë ndërmjet synimeve për t'i integruar në Bashkimin Evropian dhe ruajtjes së lidhjeve me Rusinë. Presidenti serb tha të mërkurën në mbremje në Beograd se e ka siguruar presidentin rus se Serbia nuk do të marrë pjesë në kurrfarë masash kundër federatës ruse dhe nuk do të dëbojë diplomatët e saj, pavarësisht faktit se pothuajse të gjitha vendet e rajonit ku ndodhet Serbia e kanë bërë tashmë një gjë të tillë.

Agjencia e Trajtitimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara

Lista IV/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrë apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion më të deta-

juar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

DOSET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67%

të të gjithë vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | VLERESIMI |
|-------|-------------------------|--------|-----------|
|-------|-------------------------|--------|-----------|

(Vijon nga numri i djeshëm)

| | | | |
|-------------|-------------------|--|-----------|
| Fier | Perikli Ziu | | |
| Fier | Zabit Fejzullahu | | 1,042,734 |
| Fier | Zogu Gjergji | | 1,188,888 |
| Fier | Nadir Ferko | | 2,286,500 |
| Fier | Kovaç Paja | | 1,300,930 |
| Fier | Rrapi Sallaku | | 5,780,917 |
| Fier | Panoeli Ikonomi | | |
| Fier | Llazar Pushi | | 5,005,123 |
| Fier | Qemal Prenjasi | | 2,728,202 |
| Fier | Zaim Myftari | | |
| Fier | Haki Mala | | |
| Fier | Nuri Behaj | | 535,914 |
| Fier | Adem Borova | | |
| Fier | Naun Ikonomi | | |
| Gjirokastrë | Vilson Abazi | | |
| Korçë | Flora Kajno | | 0 |
| Korçë | Adem Guri | | 222,000 |
| Korçë | Ferik Bacelli | | |
| Korçë | Fatmir Ramolli | | 50,000 |
| Korçë | Halim Kulla | | 179,000 |
| Korçë | Beqir Bashllari | | 1,012,950 |
| Korçë | Dylber Pashollari | | 192,780 |
| Korçë | Teki Bregu | | -549,000 |
| Durrës | Xhavit Sfinjari | | 1,364,875 |
| Korçë | Fazli Agolli | | 1,070,000 |
| Durrës | Nuri Tafaruçi | | 2,678,600 |
| Korçë | Marika Tasho | | 500,000 |

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | VLERESIMI |
|-------|-------------------------|--------|-----------|
|-------|-------------------------|--------|-----------|

| | | | |
|---------|---------------------------|--|-----------|
| Korçë | Selaudin Musaj | | 71,500 |
| Durrës | Shefqet Shima | | |
| Korçë | Pellumb Agolli | | 161,538 |
| Korçë | Petraç Kapshtica | | 160,769 |
| Korçë | Violeta Terpini | | 2,469,228 |
| Korçë | Selman Koçillari | | 93,501 |
| Elbasan | BAJRAN BUDINI | | 1,943,831 |
| Elbasan | HARTIE CONIKU (HAR | | 262,837 |
| Elbasan | XHELIL MOLLAJ | | 907,449 |
| Korçë | Gurie Menkshi | | 227,916 |
| Korçë | Petref Mile | | 57,304 |
| Korçë | | | 84,998 |
| Korçë | Piro Hila | | 193,025 |
| Lezhë | Komuniteti Mysliman Lezhe | | |
| Fier | Llambi Dashi | | 2,325,781 |
| Durrës | Bajram Keçi | | |
| Durrës | Shefki Mancaku | | |
| Durrës | Vath Paja | | 0 |
| Durrës | Riza Nraxhi | | |
| Durrës | Bakushe Katreli | | 5,210,160 |
| Durrës | Tomorr Xhamia | | |
| Fier | Muharrem Rrapaj | | |
| Durrës | Bektash Kamberi | | 6,277,069 |
| Durrës | Besnik Deda | | 0 |
| Fier | trashëgimtarët | | |
| Tiranë | ISLAM DENGU | | 33,159 |
| Korçë | Thanas Kallço | | 1,909,806 |
| Elbasan | ARTAN TABAKU | | 2,350,000 |

| Qarku | Emri (Subjekti Kerkues) | Atesia | VLERESIMI |
|-------|-------------------------|--------|-----------|
|-------|-------------------------|--------|-----------|

| | | | |
|---------|-------------------------|--|-------------|
| Lezhë | Gjon Preng Gjoni | | |
| Dibër | Memet Caka | | |
| Elbasan | MYZEJEN BLOSHMI | | 1,512,142 |
| Elbasan | DALIP, FEJZULLA QAZ | | 451,251 |
| Tiranë | BAJAME VOGLI | | 1,984,100 |
| Tiranë | KIMETE XHAFERRI | | 1,184,400 |
| Tiranë | GJYLE KAJA | | 3,318,623 |
| Tiranë | SHYQYRI MAHMUDAJ | | 721,789 |
| Tiranë | SKENDER GJONI | | 1,156,204 |
| Tiranë | RESMIJE SHEHI | | 1,233,750 |
| Tiranë | SULEJMAN HASA | | 493,500 |
| Tiranë | Naim Allajbeu | | 309,800 |
| Tiranë | FADIL LUSHKJA | | 6,877,560 |
| Tiranë | Kadri Lushkja, Shaban I | | -35,402,100 |
| Tiranë | Shaban Xeka | | 185,880 |
| Tiranë | Ali Kola | | 331,632 |
| Korçë | Çiljeta Panariti | | |
| Korçë | Stavri Toçi | | -222,260 |
| Korçë | Ferdinand Pengo | | 101,750 |
| Korçë | Tera Qeleshi | | 112,200 |
| Korçë | Adem Beqari | | 449,600 |
| Korçë | Sami Mollaymeri | | -14,903,588 |
| Korçë | Hodo Mullalli | | 295,500 |
| Korçë | Muharem Dushi | | 212,400 |
| Korçë | Adem Beqari | | 370,000 |
| Korçë | Shpetim Terolli | | |
| Dibër | MUSTAFA SEFERI | | 2,456,640 |
| Dibër | TAXHEDIN SHEHU | | -10,150,355 |

| | | | | | | | | |
|-------------|----------------------------|-----------|-------------|-----------------------|-----------|-------------|-------------------------|------------|
| Shkodër | Qamil Abaz Sefa | 4,159,531 | Tiranë | Shaban Dervishi | 757,935 | Tiranë | AISHE HOXHA | 0 |
| Shkodër | Halil Hyzeni(Duni) | | Tiranë | Shqipe Lecini(Habili) | 2,236,400 | Tiranë | KASEM ISMAILI | -2,115,200 |
| Shkodër | Zef Dema | 857,377 | Korçë | Ibrahim Spaho | | Tiranë | SHAQIR ALLA | 4,066,450 |
| Shkodër | Zef Leka | 245,681 | Korçë | XHEMAL HAMETLLAR | -54,272 | Tiranë | QERIM GURZI | 1,170,000 |
| Shkodër | Sepir Neziri | 6,317,514 | Dibër | ISUF KLOSI | 259,552 | Gjirokastrë | Nezet Shehu | 1,030,092 |
| Shkodër | Shpend Salihaj | | Dibër | SHEFIKATE MUCA | 219,474 | Fier | Asllan Malaj | 2,112,584 |
| Shkodër | Age Vjerdha | 105,277 | Durrës | Margarit Çumashi | | Gjirokastrë | Dilfo Spahaj | 483,112 |
| Shkodër | Sale Muharrem Kadia | 329,458 | Dibër | Bajram Zeqiri | 302,102 | Tiranë | Ramazan Çollaku | 375,536 |
| Shkodër | Majlinda Jaku | 90,083 | Gjirokastrë | Bekim Sula | 299,063 | Tiranë | Meleqe Gjoni | 1,155,903 |
| Shkodër | Ded Nik Lulguraj | 571,585 | Berat | Xhezo Shyqo Bako | | Gjirokastrë | Xhelal Resuli | |
| Gjirokastrë | Safet Shehu | | Gjirokastrë | Namik Cami | | Gjirokastrë | Hasime Ballaxhiaj | 175,259 |
| Korçë | Sotira Nane | 1,700,000 | Korçë | Hysen Ibro | -587,000 | Berat | Neim Sali Saçdanaku | 836,557 |
| Elbasan | HAMIT ÇELA | -45,000 | Korçë | Iljaz Kalemi | -156,400 | Durrës | Gëzim Balla | 6,898,545 |
| Tiranë | DYZEME TAHIRI | 727,099 | Korçë | Fatime Haderllari | | Durrës | Muharrem Kota | 1,622,267 |
| Tiranë | GJYLE SHALA (BERISHI) | 1,223,392 | Korçë | Fuat Kelo | 311,984 | Elbasan | JAKUP PRECI | |
| Tiranë | EVERHE ETJ PAZARI | 2,130,490 | Korçë | Xhafer Sulollari | 5,000 | Gjirokastrë | Bejaze Mataj | |
| Tiranë | Baftjar Mullaliu | 587,378 | Korçë | Thomaq Prifti | -79,840 | Dibër | RAMAZAN SARACI | 927,010 |
| Tiranë | AMALJA RRUFA | 1,463,591 | Korçë | Vaske Kolaci | 0 | Gjirokastrë | Dilaver Jaup Divintari | 335,276 |
| Tiranë | Shyqyri Mahmudaj | 2,523,663 | Korçë | Fatime Hadërllari | 431,962 | Gjirokastrë | Maliq Xhelo Hyseni | 694,816 |
| Tiranë | NEXHMIJE SALIU | 1,027,315 | Korçë | Radium Avxhi | 1,139,155 | Gjirokastrë | Skendo Jaho Sina | 329,394 |
| Tiranë | HATIXHE E HAXHI TOPI | 1,631,857 | Korçë | Ademije Mulla | 1,396,985 | Gjirokastrë | Demir Meraj | 1,930,968 |
| Tiranë | Gani Misiri, Serije Misiri | 908,385 | Korçë | Vangjeli Bendo | 108,000 | Gjirokastrë | Servet Dervishi | |
| Tiranë | TIXHE SPANESHI | 2,014,669 | Berat | Hysen Musabelliu | 1,353,163 | Gjirokastrë | Xhevit Çakalli | |
| Tiranë | Pranvera Babamusta | 701,946 | Berat | Adriatik Caka | 776,233 | Gjirokastrë | Isuf Çelo Rama | 664,344 |
| Tiranë | TAFIL, HALIL, ALBERT | 631,751 | Berat | Adriatik Caka | 132,956 | Gjirokastrë | Serafin Stavri | |
| Tiranë | Tahir Harizi | 1,144,941 | Berat | MEDI MYRTO LULAJ | 0 | Gjirokastrë | Qerim Pashaj | 4,099,200 |
| Tiranë | Ragip Turra | 40,780 | Gjirokastrë | Hysen Daut Shehu | | Gjirokastrë | Kostandin Rushitaj | |
| Tiranë | Moisi Teršana | 771,639 | Berat | Lule Lullolari | 601,406 | Tiranë | YLLI GJOKA | 948,838 |
| Tiranë | Qamil Dedej | 409,602 | Berat | Lule Lullolari | 784,272 | Tiranë | SEFER BALLA | 2,357,228 |
| Tiranë | Fadil Lushkja | 244,678 | Korçë | Shaban Male | 743,040 | Tiranë | HAMIT DEDJA | 908,040 |
| Tiranë | Vasip Beçerri | 1,572,610 | Korçë | Shaban Male | 1,068,693 | Tiranë | XHEMAL SULA | |
| Tiranë | Fatos Deda | 2,731,991 | Shkodër | Vishe Germaj | 299,004 | Durrës | Selaudin Qesja | |
| Berat | Aqif Kasem Delibashi | 625,902 | Shkodër | Jusuf Sylo Balidemaj | | Gjirokastrë | Kujtim Adem Laskaj | |
| Fier | Naunka Gjeci | | Shkodër | Geg Gjini Prendi | 756,996 | Dibër | Islam Kazani | |
| Gjirokastrë | Jaçe Aliaj | 2,836,530 | Shkodër | Nikoll Mark Deda | 408,067 | Dibër | Ibrahim Pulja | |
| Berat | Sali Muka | 57,937 | Shkodër | Hysen Gerberti | 145,834 | Vlorë | Pandora Zoto | |
| Berat | Resul Sefedin Sulanaku | | Shkodër | Daut Loku | 411,743 | Gjirokastrë | Axhem Hazbi Bakaj | 500,709 |
| Dibër | Liman Arriku | 142,144 | Fier | Bajram Avdia | | Gjirokastrë | Hajri Bilo Llaka | 2,033,715 |
| Durrës | Riza Zezi | | Fier | Hekuran Alliaj | | Tiranë | ASLLAN CACA | 256,730 |
| Durrës | Selami Zezi | | Fier | Pëllumb Toro | 3,856,461 | Tiranë | KUJTIM SARACI | |
| Durrës | Didare Xhemali (Shkupi) | | Fier | Nadir Ferko | 5,064,357 | Tiranë | TEFIK DUL ALIM | 3,528,525 |
| Dibër | FRAN LENA | | Fier | Vangjel Stroni | 6,554,638 | Tiranë | QERIME MEMA | |
| Dibër | FERIT HYSA | 563,897 | Fier | Refat Meraj | 145,286 | Tiranë | NAIM BEU | |
| Vlorë | Lirim Mero | 132,000 | Fier | Hamit Baxhia | 4,575,198 | Tiranë | Islam Reci | 540,200 |
| Gjirokastrë | Shega Lonari | | Fier | Nasi Shkurti | | Tiranë | HUME FILE SUMA | 1,545,642 |
| Dibër | HYSNI VLESHA | | Fier | Rrapi Mici | | Tiranë | Pëllumb Vrapci | 109,557 |
| Dibër | LIRIE KALOSHI | | Fier | Banush Shateraj | 5,657,346 | Tiranë | Mahire Pazari | 9,751,889 |
| Korçë | Xhemal Hymetllari | 727,637 | Fier | Feim Rustemi | 2,579,405 | Tiranë | | 1,645,000 |
| Korçë | Hajdhica Bice | 267,528 | Gjirokastrë | Eqerem Dashaj | | Tiranë | Haxhi Lusha | 3,343,627 |
| Korçë | Qazim Seitllari | 69,280 | Gjirokastrë | Reshat Hyseni | 1,841,814 | Tiranë | Hasan Ceka, Jashar Ceka | 2,840,889 |
| Korçë | Gjergji Kristaq Mehilli | 355,029 | Gjirokastrë | Muhamet Veizi | 489,386 | | | |
| Korçë | Fidarije Abasllari | 134,954 | Gjirokastrë | Sefer Matohiti | | | | |
| Korçë | Lavdie Alinji | 244,710 | Gjirokastrë | Bylyre Luzaj | | | | |
| Korçë | Elmije Begollari, Kame | 187,356 | Tiranë | NUREDIN KAMBERI | | | | |
| | | | Tiranë | HEKURAN HASA | 0 | | | |

(Vijon nesër)

Dje në "Deutsche Welle"

"Bllokada ruse" dhe roli i Shqipërisë

Robert Schwartz

(vijon nga faqja 1)

... Skripal pas Britanisë së Madhe e perëndimit duke dëbuar kështu diplomatë rusë. Nëse në vendet perëndimore përmendet solidariteti me Britaninë e Madhe si argument, në vende si Shqipëria, Ukraina apo Republika e Moldavisë ky dëbim është më shumë rezultat i një pragmatizmi politik. Megjithatë ky hap i këtyre vendeve nuk të habit edhe aq shumë.

Shqipëria që për afro gati dhjetë vjet është anëtare e NATO-s kërkon aktualisht të negociojë për anëtarësim në BE. Kështu ky është një rast i mirë për këtë vend të veprojë si europiane e bindur. Në një kohë që si Shqipëria, ashtu edhe Maqedonia apo Rumania, tradicionalisht kanë mbajtur qëndrime kundër Rusisë. Tek dy ish-republikat sovjetike, Ukraina dhe Moldavia qëndrimi kundër Rusisë është më i thellë. Aneksimi i Krimesë, agresioni rus në lindjen ukrainase si edhe prezenca e vazhdueshme ruse në rajonin e shkëputur moldav të Transnistriës luajnë një rol të rëndësishëm në dëbimin e diplomatëve rusë.

VENDET QË REFUZUAN DËBIMIN

Hije mbi këtë aksion hedh fakti që BE megjithatë nuk u paraqit unike, dhe vende si Austria, Bullgaria, Greqia tregohen të rezervuara me dëbimin. Por me gjithë rezervat e pak vendeve, shtetet demokratike si në Perëndim ashtu edhe Lindje të Europës dalin të bashkuara ndaj sjelljes agresive prej vitesh të Rusisë.

Numri i ndryshëm i diplomatëve të dëbuar nuk du-



het parë si dobësi. Një diplomat apo 60, jo shifra, por simbolika e aktit ka efekt në politikën ndërkombëtare. Këtë e kanë kuptuar edhe vende si Italia apo Hungaria qeveritë e të cilave kanë reaguar deri më tani miqësisht ndaj Rusisë.

Po Austria? Qeveria e re i referohet neutralitetit të republikës së alpeve dhe funksionit fisnik të urëlidhës në diplomacinë ndërkombëtare. Vjena tërhoqi vetëm ambasadorin e saj në Moskë.

Mbetet Bullgaria,

krenare që këtë gjysmë viti është presidente e radhës në BE dhe që mund të prezantojë nga ana e saj më europiane. Por me qëndrimin kundër dëbimit të diplomatëve, Sofja ka devijuar nga arritja e këtij qëllimi. Lidhjet tradicionale me Moskën duken më të forta se solidariteti evropian. Për një presidente të radhës në BE jo sinjali më i mirë. Tek grupi i vogël i refuzuesve bën pjesë edhe Greqia. As këtu nuk e ka dobësuar lidhjen e ngushtë me Rusinë, ombrella fi-

nanciare e shpëtimit të BE. Athina sërish tregoi, se xhoxlon pa problem me alternativat. Por edhe xhoxglerit më të mirë i shpëton diçka.

Me interes priten masat, me të cilat kërcënon Moskë. Varet nga Rusia dhe presidenti i porsazgjedhur rus, Vladimir Putin nëse shkallëzimi do të vazhdojë. Një pjesëmarrje e Rusisë në zbardhjen e skandalit me gaz helmues me siguri është zgjidhja më e mirë se sa mbyllja e Institutit Kulturor Britanik.

LETËR NE REDAKSI

Mbi një deformim rreth protestave të para demokratike në Kavajë

Rexhep Rugeja *

Përsëhendetje, z. Kryeredaktor i "Gazetës Shqiptare"!

Quhem Rexhep Rugeja, banues në Kavajë. Shqetësimi im është: Në "Gazetën Shqiptare" të datës 26 mars 2018, të ditës së hënë, në adresë të librit tim në kujtimet e mia, siç thotë dhe autori i këtij shkrimi, ka shtrembërim të historisë, gjë të cilën e ka bërë autori i shkrimit Xhevat Mustafa. Kam librin tim përpara ku mund të përmend shkurtimisht disa nga ngjarjet që nuk ndodhen në librin tim, të cilat janë shtrembëruar.

1) Autori Xhevat Mustafa thotë: Xhevat Hylviu i arrestuar, gjë e cila nuk është në librin tim.

2) I tërë stadiumi, mijëra qytetarë u ngritën në këmbë, duke grisur veprat e Enver Hoxhës, edhe kjo nuk ndodhet në librin tim pasi këtu ka zmadhim të numrit.

3) Tahir Okshtuni është i arrestuar, por jo në datën 27 dhe 28 mars 1990, dhe kjo nuk qëndron.

4) Në policinë e Kavajës unë nuk kam përmendur që britmat e nënave dhe vajzave me të qarat e tyre dëgjoheshin shumë larg, dhe kjo nuk qëndron.

5) I riu Betim Misiri, çau kordonin e policisë dhe u fut në mesfushë. Në këtë libër këtë person nuk e kam përmendur. Në librin e parë, po. Por nëse do t'i referohemi së vërtetës dokumenteve dhe dëshmitarëve okular ku në librat e mi dhe në shumë kasete dhe në të 4 librat e mi historia fillon me ne dy vëllezër, ku autori i shkrimit ju vetëm deformon historinë, por ne na lë në hije, por dhe na anashkalon duke na përmendur vetëm emrat si të arrestuar ku gjithçka filloi me ne dhe deri me 5 prill populli i Kavajës na

është gjendur pranë.

Betim Misiri ishte një person i nderuar me fizik të dobët, i cili kishte probleme shëndetësore me këmbën, por pavarësisht problemeve shëndetësore ai ka meritat e tij pavarësisht se u hodh në fushë nga grupi ynë, por kjo ngjarje ka ndodhur pasi unë kisha thërritur Liri-Demokrati, grupi ynë këndoi këngë patriotike, përlëshja me sambistët nga grupi ynë, arrestimit të Ilir Rugejës dhe rrahja e tij barbare nga sambistët para 12 mijë shikuesve, që nuk janë vendosur nga ana e autorit.

Pra, ngjarja e Misirit nuk është në fillim, siç e ka vendosur autori i shkrimit por pas këtyre ngjarjeve. Por autori anashkalon edhe ngjarjen që tronditi dhe zemëroi popullin e Kavajës, ku ne dy vëllezër ishim torturuar në mënyrën më barbare, na kishte rënë disa herë të fikët në birucat e Durrësit, vëllait tim Ilirit i doli dhe vdekja dhe populli i Kavajës u ngrit i tëri në këmbë duke përkrahur familjen time. Kjo ishte protesta e tretë pas policisë, por më e madhe, mbarë popullorë dhe kjo ndodhet në librin tim.

6) Më 26 mars në policinë e Kavajës, por dhe në qytet nuk i është vënë zjarri makinave. Dhe kjo nuk qëndron në librin tim. Makinave i është vënë zjarri me 10 korrik të 1990 në varrimin e Dëshmorit të parë të demokracisë shqiptare Josif Buda. Ka dhe disa shtrembërimë të tjera, por këto janë më të theksuarat. Personi, në radhë të parë, duhet të më njoftonte mua pasi po shkruan në emrin tim. Dhe së dyti, ka deformuar qëllimisht historinë, e cila nuk qëndron në librin tim.

* Me respekt, autori i librit "Stadiumi 'Besa' dhe ngjarjet e 1990 në Kavajë"

Opinion *i* Ditës

Refuzojeni atë taksë, jo si kosovarë, por si qytetarë

Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... për faktin që ashtu sikurse pretendon gjithkush, ai ngre një mur të ri mes Shqipërisë dhe Kosovës. Jo vetëm për debatin zhurmëm madh të prishtinalive të etur për det. Jo vetëm për protestën e shoferëve të mauneve, që u rritet ndjeshëm çmimi i mallrave që transportojnë në të dyja anët. Ai është një akt i pastër talljeje me të gjithë qytetarët shqiptarë. Sidomos i tillë është argumenti që po përmendet gjithnjë e më shpesh nën tryezë, se Rilindja trashëgoi nga Berisha një "rrugë pa rrugë", me ura të papërfunduara dhe me kors të shqyera dhe prandaj duhet të paguajnë qytetarët që ajo të bëhet me standarde perëndimore. Për mangësitë e rrugës nuk ka dyshim: është një gjë që e ka parë gjithkush. Po ashtu, gjithkush ka dëgjuar, për një dekadë me radhë retorikën socialiste për 230 milionë dollarët që u vodhën nga dysheja Berisha-Basha për ndërtimin e kësaj vepre. Sa herë në këto vite na janë shurdhuar veshët duke folur për vjedhjen e shekullit, për Lulzim Bashën që e mbylli këtë proces me procedurë, për paratë që përfunduan për lobim në SHBA, apo te mikut turk i Berishës, pronari miliarder i Enkës. Pra, gjatë gjithë periudhës së qeverisë së shkuar, por edhe sot në pushtet, sa herë kanë nevojë, Rama dhe socialistët i mbahen së njëjtës tezë: autostrada e kombit mbeti si "rrugë pa rrugë" sepse ajo ra pre e një kusarie kolosale. Ata vazhdojnë t'i qëndrojnë kësaj ideje edhe tani që kanë pesë vite në pushtet, që kanë kryer reformën në drejtësi dhe që kanë rrembyer



prokuroren e tyre. Por, pavarësisht nga këto, pavarësisht nga fakti se e pranojnë se qytetarët qenqëshin vjedhur njëherë, ata kanë arritur në përfundimin se ata duhet të paguajnë sërish. Dhe pikërisht këtu qëndron imoraliteti skandaloz i kësaj takse të lartë. Sepse përveçse i rëndë ekonomikisht dhe i papërligjur rajonalisht, ai sanksionon një parim pervers: sa herë që vjedhin pushtetarët,

duhet të rifusin dorën në xhep qytetarët. Prandaj ky çmim skandaloz (10 euro vajtje-ardhje) duhet kundërshtuar. Sepse nëse e pranojmë sot parimin e vjedhjes së dyfishtë, kjo histori nuk do të ndalojë më kurrë. Nëse kryeminstri po u thotë sot shqiptarëve, paguani sërish për rrugën se iu vodhi Berisha, ai që do ta zëvendësojë atë nesër, nuk do të ketë më frikë të përdorë të

njëjtën logjikë: shkundni xhepat për check-up, diazlizën dhe analizat laboratorike se paratë e koncesioneve të para i përpiu Edi Rama. Prandaj kjo taksë imorale nuk duhet refuzuar as si kosovar dhe as si kuksian, as si shofer dhe as si pasagjer, as si tregtar mallrash dhe as si konsumator por thjesht si qytetar që nuk do të nëpërkëmbet. **"Lapsl.al"**

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

HOROSKOPI

DASHI

Jeni të shpërqendruar disi, por fatmirësisht do të arrini t'i fshihni mirë dobësitë e juaja. Nuk do të keni probleme. Nëse nuk e dini diçka, mos bëni sikur e dini. Më mirë të thuash menjëherë të vërtetën, për të shmangur gjera të pakëndshme.

DEMI

Ngjarje të rëndësime të lidhura me punën, që janë bërë më urgjente me lëvizjet e Jupiterit jo shumë miqësor, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e jetës në çift. Nuk do të jetë e lehtë të gjeni në një ekulibër midis jetës private dhe profesionale, por ju do t'ia dini.

BINJAKET

Nëse ke zvarritur për në fund dytrat më të mërzitshme, tani duhet të bëni përmirësime. Kjo është e vetmja rrugë për t'i rimarrë gjërat në dorë. Lërimi mënjana projektet fantastikë, që nuk kanë lidhje me realitetin: kthehuni me këmbë në tokë.

GAFORJA

Një shtetje jashtë shtepisë është ajo që ju duhet për t'u shkëputur nga rutina e përditshme e ndoshta edhe për të vizituar vende të reja dhe interesante. Keni nevojë të ushqeni fantazinë tuaj, dhe leximi i një libri të mirë mund të jetë ajo për të cilën keni nevojë.

LUANI

Për të hequr ndonjë mendim jo shumë pozitiv, mendoni për çdo gjë të bukur në jetën e juaj. Menjëherë do ta kuptoni se jeni shumë me fat! Të ndryshosh nuk është e gabuar, por para se të vptoni duhet të keni në mendje në projekt shumë të qartë.

VRIGJERESHA

Favorizimi i planetëve nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë, për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengesë. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani më në fund gjithçka zhblokohe. Përfitoni nga mundësia për të menduar për të ardhmen.

PESHORJA

Paqëndrueshmërisë së juaj i bashkohet edhe nervozizmi, duke krijuar një mik jo të këndshëm. Më mirë të gjeni zgjidhje dhe të mos kërkoni më shumë probleme. Nëse sot nuk do të punoni, do keni kohë për të bërë pazar e për të blerë gjera që ju pëlqejnë.

AKREPI

Puna e mërzitshme mund të presë, sot për ju vetëm argëtim dhe hobi të shëndetshme dhe të këndshme. Kështu mund të kaloni kohën duke pikturuar, apo edhe pas sobës, duke përgatitur ushqime të shijshme!

SHIGJETARI

Keni përgjithshur një person pa u menduar shumë, por tani duhet të ndreqni situatën, duke qenë se e keni kuptuar si është puna. Ju takon të bëni një hap mbra... T'u riktheheni gjërave është një lëvizje e zgjuar, kur e keni kuptuar se keni gabuar. Më mirë vonë se kurrë!

BRICJAPI

Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë. Me Jupiterin në shenjën e juaj do të keni mundësinë që të shtoni talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u sforcuar.

UJORI

Të humbësh një mundësi të mirë nuk është e këndshme, por tani mos e dramazoni. Kërkoni të tjerë, ndoshta edhe më të mira, kështu do të keni diçka për t'u ngushëlluar. Mos u dekurajoni përballë dyshimeve të ndokujt. Nevojitet kohë për t'ia dalë që ta bindni.

PESHQIT

Bashkëpërimi i planetëve mund të krijojë mundësinë e duhur për të menduar rreth asaj gjëje që doni me të vërtetë, duke braktisur dërrimitet që nuk sjellin gjë. Një përpjekje fizike e tepër mund të t'ju krijojë shqetësimë. Prandaj merruni me sport, por me masë.

Skënderbeu do ta apelojë çështjen në KAS dhe më pas në Gjykatën Federale të Zvicrës, nëse s'fiton në Lozanë

UEFA "masakron" Skënderbeun, 10 vite pezullim, 1 mln euro gjobë

Disiplina la në fuqi kërkesën e hetuesve Dont-Fernandez



Jeton Selimi

UEFA ka dënuar rëndë Skënderbeun! Klubi korçar është pezulluar 10 vite nga Kupat e Europës dhe është gjobitur me 1 milion euro, dënim ky që u propozua më 7 shkurt nga dyshja e hetuesve Dont-Fernandez. Tashmë shpresa e Skënderbeut është KAS-i i Lozanës.

Parashikohej të ishte një shtrëngatë, por ishte edhe më keq se kaq! Vendimi i UEFA-s për Skënderbeun është çarmatosës, më i rëndi i dhënë ndonjëherë në historinë e futbollit evropian në çështje trukimesh. 10 vite pezullim nga veprimtaritë europiane dhe 1 milion euro gjobë. Dënim që do të rrenonin edhe klubet e mëdha me superbuxhet dhe jo më një klub modest nga Shqipëria.

Komisioni i Etikës dhe

SEANCA

Seanca e parë do të jetë në KAS të Lozanës, ku shanset për fitore nuk janë të shumta, ndonëse shpresat janë të mëdha. Arsyja ka të bëjë me faktin se ndeshjet mbi të cilat u ndëshkua Skënderbeu me vendim disiplinor janë të njëjtat me të cilat u ndëshkua nga vendimi administrativ i dy viteve më pas.



Disiplinës në UEFA ka lënë në fuqi kërkesën e dy investigatorëve të Nionit, Karl Dont dhe Migel Fernandez, që në raportin e tyre të datës 7 shkurt patën argumentuar në 93 faqe arsyet se përse kërkonin 10 vjet pezullim nga veprimtaritë europiane dhe 1 milion euro gjobë për klubin korçar. Vendimi i

UEFA-s daton më 21 mars, ditë në të cilën Skënderbeu njoftoi se kishte zhvilluar një seancë dëgjimore lidhur me çështjen në fjalë, por në të vërtetë ka qenë seanca finale në zyrat e Komisionit të Etikës dhe Disiplinës, ndonëse u tha se vendimi pritej të merrej më ditët në vijim. Skënderbeu

në njoftimin e tij u shpreh se nuk ka shpresa të fitojë ndaj UEFA-s, kur në të vërtetë kishte humbur, por u përpoq në të gjitha mënyrat për ta zburuar dhe vonuar të vërtetën. Tashmë rrugëtimi i Skënderbeut është i përcaktuar. Seanca e parë do të jetë në KAS të Lozanës, ku shanset për fi-

tore nuk janë të shumta, ndonëse shpresat janë të mëdha. Arsyja ka të bëjë me faktin se ndeshjet mbi të cilat u ndëshkua Skënderbeu me vendim disiplinor janë të njëjtat me të cilat u ndëshkua nga vendimi administrativ i dy viteve më pas. Jo më kot presidenti i korçarëve, Ardjan Takaj, në një prononcim të fundit u shpreh se do ta ndjekë çështjen deri në zyrat e Gjykatës Federale të Zvicrës, por nga sot deri në fund të qershorit, kur edhe hidhet shorti i Kupave të Europës, Skënderbeun e presin muaj ferri.

Reagon Takaj: Garantohet tifozyt, do jemi në Champions!

Presidenti i Skënderbeut, Ardjan Takaj, në një bisedë ekskluzive për "Panorama Sport" deklaroi: "Jemi të pastër nga kjo histori, dihej që ky do të ishte vendimi. Ne jemi të bindur për pafajësinë. Edhe nëse KAS e lë në fuqi këtë vendim, do të shkojmë Gjykatën Federale të Zvicrës. Tifozyt e Skënderbeut i garantohet se do të jemi pjesë e Champions-it këtë sezon", - ka thënë Takaj.

RAPORTI

Ja katër ndeshjet që fundosën korçarët.

Skënderbeu është njohur me dënimin e Disiplinës së UEFA-s në ditën e djeshme, teksa i është vendosur një pezullim prej 10 vitesh nga aktivitetet ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe 1 milion euro gjobë kundër klubit korçar. Megjithatë, ndeshjet që kanë fundosur klubin korçar, të cilat janë parë si ndeshje të



trukuara, janë 4 përballjet europiane të Skënderbeut. Në takimet që janë marrë për bazë për dënimin nuk ka asnjë në kampionatin shqiptar, edhe pse UEFA pretendon se korçarët kanë manipuluar më shumë se 50 ndeshje, ku përfshihen edhe ato të Superiores.

Pjesë nga raporti:

1) Kruasaders-Skënder-

beu: Në mënyrë të përgjithshme, këto modele bastesh tërësisht anormale tregojnë se një periudhë specifike e ndeshjes ishte manipuluar, për të siguruar përfitimë nga bastet në mënyrë korruptive.

2) Dinamo Zagreb-Skënderbeu: Prova për të mbështetur këtë konkluzion është shumë e madhe, me

baste shumë dyshuese, Skënderbeu qëllimisht tentoi të pësonte të paktën dy gola të vonë.

3) Sporting-Skënderbeu: Ka prova të konsiderueshme për të treguar se ka një përpjekje të organizuar për të gjenuar përfitimë korruptive nga bastet nga kjo ndeshje. Asnjë justifikim nuk mund të provohet për baste shumë të larta për Skënderbeun, që të pësojë të paktën një gol të vonë në ndeshje dhe për të paktën 6 gola të shënuar në total.

4) Skënderbeu-Lokomotiv Moskë: Nuk ka faktorë mbështetës që mund të llogariten për modelet e bastit live shumë të dyshimtë, të cilat janë vendosur për Skënderbeun të humbasë me të paktën dy gola diferencë dhe për të paktën 2 ose 3 gola të shënuar në total. Në mënyrë të përgjithshme, teoria e provave sugjeron se Skënderbeu manipuloi këtë ndeshje për të siguruar përfitimë nga bastet e korruptuara në një skemë që u ekzekutua në një mënyrë shumë të organizuar.

EUROPIANI I PESHËNGRITJES



Zhngëjten

Daniel Godelli, braktis garën

Daniel Godelli ishte shpresa e madhe e Shqipërisë në prag të Europianit të Peshëngritjes në Bukuresht, por shtangisti nga Peqini nuk arriti të përmbushë pritshmëritë. Godelli shikohej si favorit absolut në kategorinë e peshës trupore 77 kilogramë, teksa hynte në garë me të paktën 5 kilogramë diferencë më shumë sesa rivali më i afërt, që ishte rumuni Razvan Martin. Madje, Godelli hyri në garë në stilin e shkëputjes, kur të gjithë rivalët e tij kishin mbaruar provat. Madje, pati edhe luksin që të zbriste peshën nga 160 kilogramë fillëtarë në 159, por cuditërisht nuk arriti të ngrejë asnjërin prej tyre! Me medaljen e artë të ikur në shkëputje, automatikisht Godelli humbiste edhe mundësinë të kualifikohet në dygarësh ndaj e braktisi edhe stilin e dytë, atë të shtytjes, duke dështuar totalisht në Europianin që po zhvillohet në Rumani.

ISH-TRAJNERI


Josa: Më vjen keq për Skënderbeun!

Të dënohen shkelësit!

Ish-trajneri i Skënderbeut, që e udhëhoqi klubin korçar drejt 4 titujve kampionë, Mirel Josa, ka reaguar në lidhje me dënimin që UEFA i ka dhënë klubit korçar, duke e përjashtuar me 10 vjet nga çdo kompeticion evropian. Në një prononcim për "Insport.com", ai shprehet se ndihet shumë keq për vendimin që ka marrë UEFA, duke kërkuar njëkohësisht që të gjenden fajtorët. Në raportin e bërë publik nga UEFA, përmendet edhe emri i Mirel Josës, por ai shprehet se ndihet i pastër. "Ndihem shumë, shumë keq për këtë lajm. Vërtet jam i shokuar dhe nuk kam koment. Ka dy vjet që jam shkëputur me Skënderbeun. Sidoqoftë, ky lajm është shumë i keq. Nëse UEFA vërtet ka fakte për ato që i ka thënë, atëherë duhet shikuar kush janë ata njerëz që kanë vepruar kundërligjshëm. Kjo është një gjë shumë e keqe për futbollin në përgjithësi dhe për futbollin shqiptar në veçanti", u shpreh trajneri i Prishtinës, Josa. Skënderbeu drejtohej nga vetë Mirel Josa në ndeshjet të cilat janë marrë nën hetim nga UEFA.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Një pije freskuese.
7. Graf ish tenisist.
12. Dada, ish-diktator i Ugandës.
13. Eshhtë pasuri e investuar.
15. Mund të jenë fetare.
16. Një pjesë e relacionit.
17. Fillojnë ambalazhimin.
19. Një vegël.
20. Qe harkëtar i famshëm i akcjeve.
24. Fillojnë hetimin.
25. Një atentator vëtvërsasës.
26. Kështu janë takimet zyrtare.
29. Eshhtë anije me dy skafe.
31. Fundi i Turandot.
32. Inicialet e Reitman regjisor.
33. Farrell regjisor.
34. Schneider që qe aktore.

36. Mund të jetë e lirë për hartim.
38. Emri i Pasternak.
39. Ekberg e La dolce vita.
42. Dikur quhej Mediolanum.
43. Ruajnë pa ujë.
44. Një mund të jetë kalendarik.
46. Një është meskini, shpirtngushti.
47. Një hidrokarbur.
48. Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
2. Zola shkrimtar.
3. Janë dritë të tilla me parsec.
4. Mund të jenë gjaku.
5. United Kingdom.
6. Eshhtë njeri me principe.
7. Një polimer për kirurgji estetike.
8. Kufizojnë takimet.
9. Diftong teatral.
10. Fillojnë fluturimin.
11. Makina Uno.
14. Eshhtë shpend lagune.
18. Eshhtë operator që bën zoom.
20. Eshhtë i pashpirt.
21. Parashësë për një.
22. Pak enigmatike.
23. Një pjesë e Toskërisë.
25. Agustini ish-bomber.
26. Kufizojnë një princip.
27. Miku i Batman.
28. Tapeti për judo.
29. Janë stadet në videogame.
30. Bëhet një kundër vendimit.
34. Janë me blerim mbuluar në një film.
35. Eshhtë shtet aziatik.
37. Papavrami violinist.
38. Fadlii komik.
40. Përhëndetja e Jul Qezarit.
41. Mbyllin fushatat.
42. Me të bëjnë një ketër.
45. Mbyllin një takimim.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Një pemë gjigante.
6. Janë për të kërcyer.
13. Ishte shkolla e Aristotelit.
15. Një thirrje me emra.
17. Gjysmë rivale.
18. Një pjesë e narkotikëve.
19. Një tis... mjegulle.
20. E famshme ajo e Keopst.
23. Mbyllin një sirtar.
24. Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
25. Fillojnë lejen.
26. Janë aktorë kryesorë.
29. Janë kompozime të kënduara.
30. Hudson aktore.
31. Satelit i Uranit.
32. Fillojnë tatëpjepën.
33. Mbetur në fund.
34. Sapo fillojnë.
35. Kastile janë në fund.
36. Kufij takimi.
38. Ekstremet e tokës.


40. Inicialet e Einstein.
41. Qendër mësimi.
42. Kështu thirrej Marco Pantani.
45. Pak irredentizëm.
47. Fundi i një filmi.
48. Popullonjë qytetin.
49. Janë gojë vullkanesh.
50. Eshhtë edhe ai Persik.

VERTIKAL


1. Mund të jetë sekrete në derë.
2. Makina Agila.
3. Ami i Maupassant.
4. Mbyllin një sirtar.
5. Rrëzohen me strike.
6. Luciano tenor i paharruar.
7. Mbyllin këndet.
8. Eshhtë borxh.
9. Mbyllin portat.
10. Hagen rockstar.
11. Një pjesë e akademisë.
12. Bilen me ballë.
14. Një barkë lëkurëkuqsh.
16. Atje ku shkon progresisti.
20. Pallati i Dalai Lamas në Lhasa.
21. Një pjesë e minoritetit.
22. Eshhtë fluturues në ufo.
24. Do të bëhen mace të tilla.
25. Fletë pa kufij.
27. I ka tek rendi.
28. Kreshniku i volejbollit.
29. Një det që është liqen në fakt.
36. As unë, as ai.
37. Në mes të King edhe Cole të muzikës.
39. Një parashësë zmadhuese.
40. Eshhtë Ilon pagagalli.
41. Titulli i Sean Connery.
42. Fillojnë panikun.
43. Gjysma e rojave.
44. Fitim pa kufij.
46. Mbyllin një sherr.
47. Fillojnë një metodë.
48. Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



- Dora e butë thyen edhe gurin më të fortë. Fjala e ëmbël zbut dhe zemrën më të egër...
- Dhimbja e nxit njeriun të mendojë. Mendimi e bën njeriun të mençur. Mençuria e bën jetën të lehtë.
- Prej njëqind sëmundjeve, pesëdhjetë shkaktohen nga gabimet tona e pesëdhjetë të tjera nga mosdija jonë.
- Për të patur sukses, dëshira jote për sukses duhet të jetë më e madhe se frika nga dështimi...

Bill Cosby


Thënie të mençura

- Mënçuria nuk vjen automatikisht me kalimin e viteve. Asgjë nuk vjen me vitet - përveç rrudhave kuptohet, vetëm verërat bëhen më të mira në vite por, nëse rrushi ka qenë i mirë.
- "Çdo dalje është një hyrje për dikë." Tom Stoppard
- Njerëzit mërziten nga fëmijëria, nxitojnë të rriten, më pas shpresojnë të kthehen të vegjël (fëmijë) përsëri.
- Mendimet pa përmbajtje janë bosh, intuitat pa koncepte janë të verbra.

Abigail Van Buren

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|-----|
| | 2 | 6 | | | | | | 4 |
| | | | 4 | 8 | 7 | | | |
| 3 | | 8 | | 2 | | | | 5 1 |
| | 5 | | | | 1 | 3 | 9 | 2 |
| | | 2 | 8 | | 3 | 4 | | |
| 6 | 3 | 7 | 2 | | | | | 1 |
| 4 | 7 | | | 1 | | 8 | | 5 |
| | | 5 | 3 | 9 | 8 | | | |
| 1 | | | | 4 | 2 | 6 | | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 6 | 7 | 9 | 2 | 3 | 1 | 8 | 5 |
| 8 | 9 | 5 | 7 | 1 | 4 | 6 | 3 | 2 |
| 2 | 3 | 1 | 5 | 8 | 6 | 4 | 7 | 9 |
| 7 | 4 | 8 | 2 | 5 | 9 | 3 | 6 | 1 |
| 6 | 5 | 3 | 8 | 4 | 1 | 9 | 2 | 7 |
| 9 | 1 | 2 | 6 | 3 | 7 | 8 | 5 | 4 |
| 5 | 7 | 6 | 1 | 9 | 8 | 2 | 4 | 3 |
| 3 | 2 | 9 | 4 | 6 | 5 | 7 | 1 | 8 |
| 1 | 8 | 4 | 3 | 7 | 2 | 5 | 9 | 6 |

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

